



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 261 Akti

Nr. 472 Vendimi
Tiranë, më 4.11.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 2.11.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Nazmi Troka**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Nazmi Troka, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më 15.1.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues datë 15.1.2019, u caktua me mirëkuptim kryesues komisioner Lulzim Hamitaj. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Francesco Ciardi. Komisioni, me vendimin nr. 18, datë 9.3.2020, ka vendosur me short zëvendësimin e anëtares Alma Faskaj për arsye objektive, duke u zëvendësuar me komisionere Firdes Shuli. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit. Në datën 8.10.2021 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ dhe rezultatet paraprake të këtij hetimi.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, vlerësimi i pasurisë, të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

5. Inspektorati i Lartë i Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

¹Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2018.

- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, i mbledhur në datën 8.10.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Nazmi Troka, njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit administrativ në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Z. Nazmi Troka, për një proces të rregullt ligjor, i janë garantuar të drejtat si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërja e trupit gjykues; dhe përfundimi kryesisht i hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 8.10.2021, subjektit iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Subjekti i rivlerësimit Nazmi Troka, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegime dhe prova në datën 22.10.2021 dhe lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, me prapësimet e depozituara në datën 22.10.2021, ndër të tjera, ka kërkuar rihapjen e hetimit dhe kryerjen e rivlerësimit për dy kriteret e tjera, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional. Komisioni shqyrtoi kërkesën e mbledhur më 25.10.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe pas një vlerësimi paraprak të provave të depozituara nga subjekti, në përfundim, vendosi për riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera, si dhe të shprehet pas seancës dëgjimore dhe pas shqyrtimit të të gjitha akteve dhe pretendimeve të parashtruara nga subjekti.

Komisioni vlerësoi se provat e administruara deri në seancën dëgjimore, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kishin arritur nivelin e provueshmërisë dhe ishin të mjaftueshme për përfundimin e procesit administrativ duke u bazuar vetëm mbi këtë kriter, atë të pasurisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

12. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 27.10.2021. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 2.11.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

14. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancën dëgjimore dhe shprehu opinionin në lidhje me procesin e rivlerësimit.

15. Në vijim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe, në përfundim, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit Nazmi Troka ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z. Nazmi Troka ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni dhe ka qenë i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20. Ndërsa sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësinë për fshehje të pasurisë dhe në deklarinimin e rremë apo konfliktin e interesit.

Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga z. Nazmi Troka në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, ku ka deklaruar këto pasuri:

1. **Tokë e përfituar me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”, sipas AMTP-së nr. ***, datë 22.2.1992**, ku sip. 7.800 m² është tokë arë dhe sip. 200 m² truall, ndarë në disa ngastra, respektivisht me sip. 1.000 m², 5.500 m² dhe 1500 m², në fshatin T, Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë

Toka është e regjistruar në ZVRPP-në Kuçovë, por subjekti ka deklaruar se nuk është pajisur me certifikatë pronësie. Kjo pasuri është e pavlerësuar dhe është përfituar si familje bujqësore. Për këtë pasuri subjekti ka paraqitur:

- Vërtetimin nr. ***, datë 1.11.2016, nga ZVRPP-ja Kuçovë, sipas të cilit familja e shtetasit Nazmi Troka, në fshatin T, Njësia Administrative P, Kuçovë, ka marrë në pronësi sipas ligjit nr. 7501/1991, me AMTP nr. ***, tokë bujqësore si vijon:
 - arë, z. k. ***, nr. *** pasurie, sipas AMTP-së me sip. 1000 m², sipas përditësimit e regjistruar në vol. *, f. ***, në ZVRPP Kuçovë me sip. 1140 m²;
 - arë, z. k. ***, nr. *** pasurie, sipas AMTP sip. 5503 m², sipas përditësimit e regjistruar në vol. *, f. ***, në ZVRPP Kuçovë me sip. 1140 m²;
 - arë + truall, z. k. ***, nr. *** pasurie, sipas AMTP sip. 1500 m², sipas përditësimit e regjistruar në vol. *, f. ***, në ZVRPP Kuçovë, me sip. 2740 m², nga këto 200 m² truall dhe 99 m² ndërtesë.
- AMTP-në nr. ***, datë 22.12.1992, ku z. Nazmi Troka, si përfaqësues i familjes bujqësore ka marrë në pronësi tokë gjithsej me sip. 8.000 m² (arë me sip. 7.800 m² dhe truall me sip. 200 m²).

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ASHK-ja Kuçovë² ka konfirmuar se subjekti Nazmi B Troka, me statusin e përfaqësuesit të familjes bujqësore, ka përfituar nga ligji nr. 7501/1991, sipas AMTP-së nr. ***, në fshatin T, Kuçovë:

- pasurinë nr. ***, arë + truall, me sip. 2740 m², nga të cilat 200 m² truall dhe 99 m² ndërtesë, për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie;
- pasurinë nr. ***, e llojit “arë” me sip. 5503 m², për të cilën nuk është lëshuar certifikatë pronësie;
- pasuria nr. ***, e llojit “arë” me sip. 1140 m², për të cilën nuk është lëshuar certifikatë pronësie.

Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se deklarimi i subjektit nuk përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ZVRPP-së Kuçovë, pasi referuar kartelave të pasurisë në emër të subjektit ka rezultuar një sipërfaqe toke më e madhe sesa është përfituar sipas ligjit nr. 7501/1991.

Subjekti, i pyetur nga Komisioni, në lidhje me mospërputhjet e sipërfaqeve të tokës së përfituar nga ligji nr. 7501/1991, ka shpjeguar³ se: *“Mospërputhja e sipërfaqeve ka ardhur si rezultat i gabimeve në matje në ndarjen e tokës dhe gjatë përditësimit të tokave të ndara për secilin fermer në vitin 1994. Kur u krye përditësimi doli sipërfaqja totale 9.383 m²”*.

Subjekti, në përgjigje të Komisionit, ka saktësuar se në pasuritë e përfituara nëpërmjet AMTP-së nr. ***, datë 22.12.1992, nuk ka bërë investime.

Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se në regjistrin kadastral janë pasqyruar AMTP-të për çdo ngastër dhe nuk është bërë verifikimi në terren i sipërfaqeve të tokës, si dhe nuk është lëshuar certifikatë pronësie.

²Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2019.

³Në përgjigjet e pyetësorit të datës 22.7.2021.

Nga hetimi i kryer për këtë pasuri rezultoi, mospërputhje e sipërfaqeve të tokës bujqësore, pasi me AMTP-në sipas ligjit nr. 7501/1991, subjekti ka përfituar tokë në sip. 8.000 m², ndërsa sipas kartelave të pasurisë sipërfaqja në total në emër të subjektit është 9.383 m².

Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë mospërputhje.

1.2 Qëndrimi i subjektit

Subjekti, në prapësime të rezultateve të hetimit, të depozituara në datën 22.10.2021, ka dhënë të njëjtat shpjegime si gjatë hetimit administrativ, ku ka shpjeguar se mospërputhjet në sipërfaqet e tokës kanë ardhur si rezultat i gabimeve në matje gjatë procesit të ndarjes së tokës në vitin 1991 dhe gjatë përditësimit të tokave të ndara për secilin fermer në vitin 1994.

Subjekti ka shpjeguar se për këtë pasuri nuk është pajisur me certifikatë pronësie dhe ka saktësuar se nuk ka kryer veprime në ASHK-në Kuçovë, por vetë institucionet shtetërore kanë reflektuar aktet zyrtare në regjistra siç është AMTP-ja me të cilën ka përfituar pasuritë. Subjekti ka shpjeguar se kur u krye përditësimi i tokave rezultoi se sipërfaqja totale e përfituar është 9.383 m², por ka pretenduar se nuk e ka verifikuar këtë ndryshim shtesë të sipërfaqes së tokës dhe nuk ka bërë asnjë pagesë për diferencën e sipërfaqes. Për këtë tokë shtesë nuk disponon dokument tjetër përveç AMTP-së dhe kjo shtesë ka dalë gjatë përditësimit pas të cilit u krijua edhe formulari nr. 6.

Sipas procedurave të përcaktuara në nenin 10/2 të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve të kalimit të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka argumentuar se do të realizohet marrja e certifikatës së pronësisë, pasi kjo tokë do të përditësohet përsëri nga ASHK-ja Kuçovë, me ekspertë topografë të këtij institucioni dhe në këtë moment do të kryhen edhe llogaritjet përkatëse dhe regjistrimi definitiv i pronës duke u pajisur me certifikatë pronësie.

Subjekti ka shpjeguar se nëse pas saktësimit dhe pozicionimit në hartën kadastrale, sipas pikës 2, të këtij neni, do rezultojë se do zotërojë sipërfaqe shtetërore shtesë, mbi atë të përcaktuar në AMTP, do ketë të drejtë të kërkojë kalimin e pronësisë për këto sipërfaqe, deri në masën 20% të sipërfaqes së tokës sipas AMTP-së, duke kryer pagesën përkatëse sipas zonës, për pjesën shtesë.

Subjekti ka pretenduar se nuk ka kryer asnjë veprim në kundërshtim me ligjin për të përfituar tokë shtesë. Ky proces dhe rregullimi i kësaj situatë do të përfundojë me marrjen e certifikatës së pronësisë, ku do të bëhen edhe saktësimet e sipërfaqeve dhe pagesat përkatëse. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka sjellë ndonjë provë shtesë për këtë pasuri.

1.3 Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjyqësor, referuar shpjegimeve të subjektit lidhur me mospërputhjet në sipërfaqet e tokës bujqësore, konstaton se nuk ka veprime të kryera nga subjekti që të ngrenë dyshime se subjekti i rivlerësimit ka përfituar në mënyrë të padrejtë apo me veprime të kundërligjshme sipërfaqe toke shtesë.

Mospërputhjet e konstatuara në sipërfaqet e tokës kanë ardhur për shkak të moskryerjes së matjeve në mënyrë të rregullt të tokave në momentin e ndarjes nga komisioni i ndarjes së tokave, si institucion kompetent.

Në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, fakteve dhe rrethanave të cilësuar sa më sipër, si dhe shpjegimeve të subjektit në prapësime, trupi gjykues arriti në konkluzionin se mospërputhjet, për sa i përket sipërfaqeve të tokës bujqësore, nuk janë përgjegjësi e subjektit të rivlerësimit.

2. Shtëpi banimi⁴, dy kate, me sip. 99 m², në fshatin T, Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë, filluar ndërtimi para vitit 1991 dhe përfunduar në vitin 2000, së bashku me anekset.

Vlera e deklaruar⁵ në deklaratën *Vetting*: 3.500.000 lekë.

Vlera e deklaruar në DPV-në e parë: 1.200.000 lekë dhe zotëron 25%.

Pjesa në përqindje: zotëron së bashku me familjen.

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga dhe toka bujqësore, si dhe materiale ndërtimi të marra nga shpërbërja e kooperativës bujqësore në vitin 1991 (tulla, gurë nga prishja e një magazine dhe hekur), hekuri përfituar nga një dynym serë diellore.

Deklarimi në DPV-në⁶ e vitit 2003: shtëpi banimi ndërtuar në vlerën 1.200.000 lekë, ku gjysma është ndërtuar para vitit 1990 dhe pjesa tjetër pas vitit 1990, ndërtuar mbi truallin me sip. 200 m² me të ardhurat familjare.

ILDKPKI-ja, për këtë pasuri, ka konstatuar:

- Deklarim i pasaktë në lidhje me vlerën e shtëpisë së banimit në fshatin T, Kuçovë, pasi, në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2003 është deklaruar shtëpi banimi e ndërtuar mbi truallin me sip. 200 m², në vlerën 1.200.000 lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë *Vetting* është deklaruar vlera 3.500.000 lekë.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, si preventiv/situacion punimesh për banesën në fshatin T, Kuçovë.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për ndërtimin e shtëpisë së banimit për periudhën 1991 – 2000, deklaruar në shumën 3.500.000 lekë.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara nga toka bujqësore.

2.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

⁴Për këtë aset subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. ***, datë 1.11.2016, nga ZVRPP-ja Kuçovë, sipas të cilit shtetasi Nazmi Troka ka një ndërtesë 2-katëshe me sip. 99 m², z. k. ***, vol. *, f. **.

⁵Në deklaratën *Vetting*.

⁶DPV-ja parë e vitit 2003.

ASHK – Kuçovë⁷ ka konfirmuar se shtetasi Nazmi B Troka, me statusin e përfaqësuesit të familjes bujqësore, ka përfituar nga ligji nr. 7501/1991, me AMTP nr. ***, në fshatin T, Kuçovë, truallin me sip. 200 m² dhe ndërtesë me sip. 99 m², sipas kartelës së pasurisë lëshuar më 16.10.2019. Në këtë shkresë nuk specifikohen katet e ndërtesës.

ASHK- Legalizime⁸ ka informuar se shtetasi Nazmi B Troka dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë si subjekte aplikuese për vetëdeklarim të ndonjë objekti informal në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimit.

OSHEE-ja⁹ informon se referuar sistemit të faturimit në emër të subjektit identifikohet një kontratë furnizimi në instancën e Beratit, nënstationi Kuçovë.

ASIG-u¹⁰ (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor) ka depozituar pamjet imazherike të printuara nga Gjeoportali Kombëtar të Ortofoto Viti 2007 (koha e fotografimit 2007-2008) dhe ortofoto të vitit 2015 (data e fotografimit 29.6.2015), për territorin në të cilin gjendet pasuria, të cilat konfirmojnë kuotat e lartësisë¹¹ për ndërtesë dykatëshe.

2.2 Burimi i krijimit

Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se kjo pasuri është krijuar me të ardhurat nga paga dhe toka bujqësore, si dhe me materiale ndërtimi të marra nga shpërbërja e kooperativës bujqësore në vitin 1991 si tulla, gurë nga prishja e një magazine dhe hekur. Hekuri është përfituar nga një dynym serë diellore.

Në DPV-në e parë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar me të ardhurat familjare.

Subjektit i është kërkuar nga Komisioni që të saktësojë dhe të depozitojë prova për burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe, në përgjigjet e pyetësorit¹², ka shpjeguar se: “*Burimi i të ardhurave kanë qenë:*

i) Të ardhurat nga paga e punës time, për periudhën 1.5.1991 – 31.12.2016.

Të ardhurat nga paga ime deri vitin 2000 kur ka përfunduar tërësisht ky investim janë në shumën 2.089.603 lekë.

ii) Të ardhurat e bashkëshortes P. T, mësuese pa shkëputje nga puna që nga data 1.9.1990 e në vazhdim, deri në dhjetor të vitit 2000, janë në shumën 559.045 lekë, që është paga bruto. Në këtë periudhë, 2 vite janë lejelindje, të ardhurat për këto dy vite nuk i gjetëm. Për vitet 1990 – 1994 nuk gjetëm të ardhurat në sigurimet shoqërore për bashkëshorten.

iii) Të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore në vitet 1992 – 2000 janë mesatarisht 200.000 lekë në vite ose 1.800.000 lekë për këtë periudhë.

iv) Gjithashtu, burim i të ardhurave në ndërtimin e banesës janë krijuar edhe nga ndihma që më ka dhënë pjesa tjetër e familjes, pasi unë u ndava nga trangu familjar dhe përfitova

⁷Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2019.

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 14.10.2019.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 15.10.2019.

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 24.9.2021.

¹¹Në shkresën e Komisionit kërkohet informacion sipas deklaramit të subjektit për ndërtesë 2 kate.

¹²Ardhur në datën 24.4.2020.

pjesën e pasurisë nga ndarja e trungut familjar, përfshi materiale ndërtimi, përfitur nga shpërndarja e pasurisë së ish-kooperativës për fshatin T.

Për sa i përket dokumentacionit që ju kërkoni sipas vërtetimit lëshuar datë 14.4.2020, nga Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë provohet se familja e shtetasit B. T ka përfitur pasuri nga shpërndarja e pronës së kësaj kooperative, por pa specifikuar llojin e pasurisë së përfitur. Siç kemi theksuar kryesisht, pasuria që përfituar nga shpërndarja e ish-kooperativës ishin materiale ndërtimi. Lidhur me dokumentacionin për ndërtimin e banesës nuk disponoj, pasi siç edhe e kam theksuar materiali për ndërtim merrej pa dokumente pasi nuk jepeshin dokumente apo fatura”.

2.3 Në lidhje me vlerën e deklaruar të shtëpisë dykatëshe

Subjektit iu kërkuan shpjegime për koston e ndërtimit të shtëpisë, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2003 ka deklaruar si vlerë shumën 1.200.000 lekë, ndërsa në deklaratën Vetting ka deklaruar vlerën e saj në shumën 3.500.000 lekë.

Subjekti ka shpjeguar¹³, ndër të tjera, se: *“Mospërputhja e shifrës 1.200.000 lekë, deklaruar në vitin 2003 me shifrën 3.500.000 lekë të deklaruar në deklaratën Vetting, ka të bëjë me faktin se në vitin 2003 ka deklaruar koston e ndërtimit të banesës. Kostoja e ndërtimit është 1.200.000 lekë dhe kjo përfaqëson shumën e shpenzuar realisht.*

Lidhur me shifrën 3.500.000 lekë, të deklaruar në deklaratën Vetting është vlera e banesës referuar Vendimit nr. 815, datë 9.12.1996, të Këshillit të Ministrave ‘Për miratimin e Vlerave Mesatare Vjetore të apartamentit tip, në tregun e lirë dhe vlerës së koeficientit ‘K’, sipas tabelës me koston mesatare të shfrytëzimit që për rrethin Kuçovë është 16.357 lekë/m². Nisur nga sipërfaqja e ndërtimit të banesës që unë kam ndërtuar 198 m² X 16.537 lekë/m² = me 3.274.326 lekë. Kjo kosto parashikohet si vlerë me kosto shtetërore në vitin 1996, kurse unë e kam ndërtuar banesën në dy faza siç dhe kam relatuar në vitet 1990 – 1996”.

2.4 Në lidhje me kohën e ndërtimit të shtëpisë dykatëshe

Në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar shtëpi banimi me sip. 99 m², e ndërtuar ½ para vitit 1990 dhe pjesa tjetër pas vitit 1990, e ndërtuar mbi truallin me sip. 200 m². Në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar: *“Shtëpi banimi 2 kate, sip. 99 m² kati. Filluar ndërtimi para vitit 1991 dhe përfunduar në vitin 2000, së bashku me anekset (pa u specifikuar katet e banesës)”.*

Në DPV-në e parë nuk është cilësuar se sa kate është kjo shtëpi, si dhe në DPV-në e viteve vijuese nuk është deklaruar kurrë shtesa apo shpenzimet për ndërtimin e katit të dytë.

Nga hetimi i kryer ishte e paqartë, si dhe nuk provohej me dokumentacion se kur ishte ndërtuar kati i dytë i shtëpisë. Të vetmet prova të depozituara nga subjekti dhe të administruara nga Komisioni për ekzistencën e katit të dytë janë dy akte të paraqitura¹⁴ prej tij, me emërtimin “vërtetim” të lëshuara nga ZVRPP-ja Kuçovë me nr. *** prot., datë 20.7.2005 dhe nr. *** prot., datë 1.11.2016, të cilat konfirmojnë se në emër të shtetasve Nazmi dhe P.Troka rezulton e regjistruar pasuria ndërtesë dy kate.

¹³Përgjigjet e pyetësorit ardhur në datën 24.4.2020.

¹⁴Në përgjigjet e pyetësorit të datës 22.7.2021.

➤ **Komisioni konstatoi paqartësi lidhur me kohën e ndërtimit të katit të dytë të shtëpisë, në fshatin T, Kuçovë.**

Për efekt të përlllogaritjes së shpenzimeve, subjekti u pyet nga Komisioni në lidhje me periudhën e ndërtimit të shtëpisë, si dhe iu kërkua dokumentacioni provues. Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar¹⁵, ndër të tjera, se: *“Kjo banesë është ndërtuar në dy periudha, para vitit 1990 dhe pas vitit 1991, në një kohë kur institucionet dhe ndërmarrjet u shpërbënë”*.

Në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme, subjekti ka depozituar dokumentacion¹⁶ provues. Subjekti është pyetur nga Komisioni në lidhje me shpenzimet e mobilimit të shtëpisë në Kuçovë. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar¹⁷ se: *“Në lidhje me mobilimin e shtëpisë në Kuçovë, ju bëj me dije se nuk kam shpenzuar lekë për mobilimin e saj, pasi kjo shtëpi ka qenë në ruajtje me mobilimin që ka pasur”*.

2.5 Regjistrimi i pasurisë

Nga aktet e administruara ka rezultuar një kartelë pasurie sipas së cilës, në emër të subjektit, janë regjistruar sipërfaqet 2.740 m² arë, 200 m² truall dhe 99 m² ndërtesë, me AMTP-në nr. ***, me datë regjistrimi 20.12.1996. Referuar kësaj karteles nuk është lëshuar certifikatë pronësie. Komisioni i ka kërkuar subjektit që të saktësojë dhe të depozitojë dokumentacionin tekniko-ligjor që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë ndërtesë.

¹⁵Ardhur në datën 24.4.2020.

¹⁶Si vijon: vërtetim nr. *** prot., datë 14.4.2020, lëshuar nga Bashkia Kuçovë, Njësia Administrative P, me të cilin vërtetohet se z. Nazmi Troka është banor në fshatin T. Njësia Administrative P/Kuçovë, si dhe ka shlyer detyrimet tatimore pranë njësisë për vitin 2019; vërtetim nr. *** prot., datë 14.4.2020, lëshuar nga Bashkia Kuçovë, Njësia Administrative P, me të cilin vërtetohet se në bazë të regjistrimit nr. *** të rishpërndarjes së ish-kooperativës, fshati T. Z. B.T ka përfituar pronë; vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga Bashkia Kuçovë, Njësia Administrative P, Zyra e Tatim-Taksave me të cilin vërtetohet se z. Nazmi Troka ka shlyer detyrimet tatimore ndaj Njësisë Administrative P, Bashkia Kuçovë; vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga Bashkia Kuçovë, Njësia Administrative P, Zyra e Kadastrës me të cilin vërtetohet se z. Nazmi Troka ka në pronësi tokë bujqësore përfituar nga ligji nr. 501/1991 “Për Tokën”, i ndryshuar, me sip. 8.000 m², ndodhur në fshatin T, me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. ***. Kjo tokë shfrytëzohet nga pronari Nazmi Troka, që nga viti 1991 e në vazhdim, dhe në të kultivon pemë frutore nga e cila siguron të ardhura; certifikatë regjistrimi të personit të tatuashëm, për fermer në emër të z. Nazmi B Troka, në T, P, Kuçovë, datë lëshimi 15.11.2016; faturë tatimore, lëshuar nga shitësi Nazmi B Troka, e datës 24.2.2018, për shitjen e 8.500 kg mandarina në shumën totale 510.000 lekë; nxjerrje llogarie bankare, ku rezultojnë pagesa të kryera në emër të z. Nazmi Trokës nga subjekte tregtare gjatë vitit 2019; vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me të cilin vërtetohet se z. Nazmi Troka ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë në periudhën 23.10.1993 – 30.6.1998, ku janë dhënë të dhëna mbi të ardhurat vetëm për periudhën 23.10.1993 – 31.12.1994 nuk disponohen të dhëna; vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me të cilin vërtetohet se z. Nazmi Troka ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat për periudhën 1.7.1998. – 23.10.2013, ku dhe ka përfituar të ardhura dhe paga; vërtetim nr. *** prot., datë 22.4.2020, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me të cilin vërtetohet se z. Nazmi Troka ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë, në periudhën 23.10.1993 – 30.6.1998. Për mungesë dokumentacioni, për shkak të djegies së gjykatës gjatë trazirave të vitit 1997, ka përcaktuar pagat mujore *bruto* për vitet që s’ka të dhëna 1993 dhe 1994, sipas VKM-së përkatëse; vërtetim nr. *** prot., datë 21.4.2020, lëshuar nga ISSH-ja Berat, për pagat e marra nga bashkëshortja e subjektit P.T për periudhën 1994 – 2003; librezë pune e bashkëshortes së subjektit P. T; dokumentacioni marrë nga shteti grek për të ardhurat e huadhënësit A.M datë 23.12.2019 dhe në emër të z. A.M, datë 17.4.2020; transaksionet bankare datë 31.12.2015, datë 4.1.2017 dhe datë 6.12.2019 ç’ka provon shlyerjen e huas ndaj z. A.M nga huamarrësi Nazmi Troka; transaksioni bankar në BKT datë 27.10. 2014, ku provohet se me transaksion bankar nga BKT-ja huadhënësi A.M ka kaluar tek huamarrësi Nazmi Troka në “Raiffesin Bank” shumën 25.000 euro për blerje apartamenti; deklarata e interesave private periodike/vjetore dorëzuar pranë ILDKPKI-së datë 25.3.2014, ku provohet se kam deklaruar që në atë vit se shuma 5.700 euro, në emër të vajzës B.T në “Intesa Sanpaolo Bank” e kanë burimin nga të ardhurat e familjes, si dhe toka bujqësore; kontratë huadhënieje noteriale datë 27.10.2014, lidhur midis huadhënësit A.M dhe huamarrësit Nazmi Troka, ku tregohet shuma e dhënë hua dhe afatet e shlyerjes së huas; vërtetim datë 16.4.2020, lëshuar nga shoqëria “S” sh.p.k. Berat, ku provohet se kam shitur prodhimet për shumë vite rresht pranë kësaj shoqërie; deklarata shoqëruar me vendimin nr. ***, datë 17.1.1996, të Gjykatës së Rrethit Berat dhe certifikatë regjistrimi në QKR për tregtarin e fruta-perimeve, regjistruar si person fizik S.D, i cili është aktiv me NIPT L***, të cilit i kam shitur ndër vite prodhimet; vërtetim nr. *** prot., datë 1.11.2016, lëshuar nga ZVRPP-ja Kuçovë sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Kuçovë, që provon se shtëpia në fshatin T është regjistruar në bazë të vendimeve të VKM-së në zbatim të ligjit nr. 7501 “Për Tokën” qysh në vitin 1991; situacioni i banesës; transaksioni bankar marrë nga “Intesa Sanpaolo Bank” më 6.4.2020; raport vlerësimi të tokave bujqësore, hartuar nga eksperte vlerësuese e pasurive të paluajtshme, e licencuar, znj. L. B.

¹⁷Në përgjigje të pyetësorit, ardhur në datën 8.10.2021.

Subjekti ka shpjeguar¹⁸ se: “Për herë të parë, shteti shqiptar filloi procesin e regjistrimit të banesave të zonave rurale në vitin 1995. Kjo u bë me VKM-në nr. 432, datë 14.8.1995, ‘Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit’. Ndërtesa/shtëpia e banimit është regjistruar në ASHK-në Kuçovë, në bazë të akteve ligjore që dolën në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.6.1991, ‘Për tokën’, konkretisht VKM-ja nr. 432, datë 14.8.1995, sipas së cilës u përpilua formulari nr. 1, ku regjistrohej trualli me sip. 200 m² dhe banesa e cila u gjend e ndërtuar për fermerët që përfituan tokën dhe jetonin në fshat. Në bazë të këtyre akteve është regjistruar ndërtesa me sip. 99 m² dhe trualli 200 m² në emrin Nazmi Troka, në ish-ZVRPP-në Kuçovë”.

Lidhur me dokumentacionin ligjor, subjekti ka shpjeguar se: “Të gjitha banesat e ndërtuara në fshat që i gjeti të ndërtuara Komisioni i Ndarjes së Tokës krijuar me VKM-në nr. 230, datë 23.7.1991, krahas ndarjes së tokës regjistroi truallin me sip. prej 200 m² në zonat fushore, ku u gjend e ndërtuar banesa dhe emrin e personit që jetonte në të, duke u bërë kështu edhe dokumenti ligjor i mëvonshëm për regjistrimin e ndërtesës.

Nisur nga këto veprime të komisionit të ndarjes së tokës, me VKM-në nr. 432, datë 14.8.1995, ‘Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit, kryeplaku i fshatit, me miratim të kryetarit të komunës, plotësuan formularin 01 si dokument ligjor për regjistrimin fillestar të ndërtesave në fshat ku përfshiheshin edhe shtëpitë e banimit.

Lidhur me kartelën e pasurisë për ndërtesën nuk e kam marrë pasi nuk kam filluar procedurën për regjistrimin e pasurisë, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, ‘Për tokën’, përfshi edhe ndërtesën.

Ndërtimi i shtëpisë ka filluar para vitit 1991. Lidhur me sa kërkoni që unë kam deklaruar se ka filluar para vitit 1990, kam pasur parasysht se në atë vit filloi grumbullimi i materialeve të ndërtimit dhe hapja e themeleve për ndërtimin e banesës në truallin ku unë ndërtova.

Siç u shpreha edhe më sipër, unë nuk fillova të ndërtoj kur u pajisa me truall, nëpërmjet AMTP-së së datës 22.2.1992. Kjo është data kur unë u pajisa me AMTP, por ndërtimi filloi në vitin që kam deklaruar. Theksoj edhe një herë se Komisioni i ndarjes së tokave në zbatim të ligjit për tokën dhe akteve nënligjore që dolën për zbatimin e tij regjistronte 200 m² truall për ndërtesat (shtëpitë e banimit) që i gjeti të ndërtuara, ku krahas truallit regjistroi edhe tokën arë që kishte rreth banesës. Pra, ndërtimi i banesës nuk është i lidhur me nocionin truall që përcaktohet në AMTP-në nr. ***, datë 22.2.1992, që plotësoi komisioni i ndarjes së tokës. Sqaroj se ndërtimi ka filluar më parë dhe jo kur u dokumentua ky truall në AMTP. Evidentoj faktin se trualli i pasqyruar në AMTP në emrin Nazmi Troka, vjen për shkak të gjetjes së ndërtesës kur kaloi procesi i ndarjes së tokës dhe përditësimi disa vite me vonë. Pra, po të mos kishte ndërtesë të ngritur nuk jepej trualli.

Lidhur me kartelën e pasurisë ku nuk është përcaktuar numri i kateve është një e metë që sipas VKM-së nr. 432, datë 14.8.1995, ‘Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit’ në formularin 01 nuk parashikohej asnjë rubrikë për numrin e kateve dhe, për këtë shkak, nuk pasqyrohet në kartelën e pasurisë. Mosparaqitja e numrit të kateve në

¹⁸Në përgjigjet e pyetësorit të datës 22.7.2021.

kartelën e pasurisë do të zgjidhet në momentin e aplikimit për certifikatë pronësie. Unë e kam deklaruar ndërtesën dy kate sa është faktikisht. Si dokument ligjor për regjistrimin e banesës shërbeu formulari nr. 1 që është i paplotë, pasi nuk ka rubrikë për numrin e kateve dhe se ky formular duhet të firmosej nga pronari i ndërtesës, çka nuk ka ndodhur”.

Në përgjigje të shpjegimeve, subjekti ka depozituar:

- Vërtetimin nr. *** prot., datë 26.7.2021, lëshuar nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Kuçovë, si dhe bashkëngjitur formulari nr. 1, ku konfirmohet se pasuria me nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, fshati T, e regjistruar në vol. *, f. ***, pasuri e llojit arë + truall, me sipërfaqe totale 2740 m², nga të cilat 200 m² truall dhe 99 m² ndërtesë, rezulton në pronësi të familjes bujqësore me përfaqësues Nazmi B Troka.

Kjo pasuri është përfituar në bazë të AMTP-së nr. *** të administruar në DVASHK Kuçovë, përfituar në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën” i ndryshuar dhe i shfuqizuar, për sa i përket ndërtesës kjo është përfituar në zbatim të VKM-së nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, nga ku në zbatim ka dalë edhe formulari nr. 1 për trojet dhe ndërtesat në të cilat kërkuesi figuron i regjistruar me numrin rendor ***. Në formularin nr. 1, subjekti nuk ka të pasqyruar asnjë të dhënë tjetër në lidhje me ndërtesën, si numrin e kateve apo çdo të dhënë tjetër ndërtimore, përveçse sipërfaqes së bazës së ndërtimit këto të dhëna janë në këtë format për të gjitha fshatrat e administruara nga DVASHK-ja Kuçovë.

- Vërtetimet me nr. *** prot., datë 20.7.2005 dhe nr. *** prot., datë 1.11.2016, lëshuar nga ZVRPP-ja Kuçovë, të cilët konfirmojnë se në emër të shtetasve Nazmi dhe P.Troka është e regjistruar pasuria ndërtesë dy kate.
- Kartelën e pasurisë.

Për sa më sipër, ka rezultuar se subjekti për shkak të akteve ligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, me VKM-në nr. 432, datë 14.8.1995, ka bërë regjistrimin e pasurisë truall + ndërtesë, por duke qenë se formulari nr. 1, i cili nuk ka pasur të paracaktuar një rubrikë për numrin e kateve, ka mbetur pa u saktësuar një fakt i tillë.

Mbetet i paqartë momenti i ndërtimit dhe përfundimi i katit të dytë nga subjekti. Referuar DPV-së së parë, plotësuar nga subjekti në vitin 2003, nuk janë saktësuar katet e shtëpisë.

2.6 Analiza financiare për investimin e kryer në shtëpinë dykatëshe

Analiza financiare sipas vlerës së deklaruar në deklaratën *Vetting*

Nisur nga deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting*, ku vlera e shtëpisë në fshatin T është deklaruar në shumën 3.500.000 lekë, Komisioni kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësitë e subjektit për ndërtimin e shtëpisë. Në lidhje me periudhën se kur është ndërtuar shtëpia, Komisioni u bazua në shpjegimet e subjektit sipas të cilave ndërtimi është kryer në vitet 1990 – 2000. Në analizën financiare janë reflektuar të ardhurat nga pagat të dokumentuara të subjektit për vitet 1994 – 2000 në shumën 1.858.822 lekë dhe të ardhurat e bashkëshortes si mësuese për vitet 1996 – 2000 në shumën 486.694 lekë. Shpenzimet e jetesës për periudhën

përpara vitit 2000 janë konsideruar në masën 50%¹⁹ të të ardhurave të përfituara nga subjekti dhe bashkëshortja.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për pasurinë ndërtesë dykatëshe, sipas vlerës së deklaruar në deklaratën *Vetting*, subjekti ka rezultuar me një balancë negative në shumën 2.327.265 lekë.

Për pasurinë shtëpi 2 kate, Komisioni ka konstatuar:

- Mospërputhje lidhur me vlerën e shtëpisë të deklaruar në deklaratën *Vetting* me DPV-në e vitit 2003.
- Mungesë dokumentacioni ligjor për ndërtimin e shtëpisë dykatëshe.
- Mungesë burimesh të ligjshme për ndërtimin e shtëpisë në shumën 2.327.265 lekë.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

2.7 Qëndrimi i subjektit

i. Në prapësimet e depozituara në datën 22.10.2021, subjekti ka shpjeguar se ndërtimi i shtëpisë ka filluar para viteve 1990 dhe ka përfunduar në vitin 1994, ndërsa ka hyrë përfundimisht në këtë banesë në vitin 2000. Subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i kateve të kësaj banese në deklarin e tij të parë në vitin 2003 është një pasaktësi në deklarin dhe nuk ka pasur asnjë qëllim tjetër.

ii. Në lidhje me procedurat e regjistrimit të pasurisë, subjekti ka shpjeguar se shtëpia e banimit është regjistruar në ASHK-në Kuçovë, në bazë të akteve ligjore që dolën në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.6.1991, “Për tokën”, konkretisht me VKM-në nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonat urbane të fshatit”, sipas të cilit u përpilua formulari nr. 1, ku regjistrohej trualli me sip. 200 m² dhe banesa, e cila u gjend e ndërtuar për fermerët që përfituan tokë dhe jetonin në fshat. Në bazë të këtyre akteve është regjistruar ndërtesa me sip. 99 m² dhe trualli me sip. 200 m², në emër të subjektit të rivlerësimit Nazmi Trokës.

Subjekti ka shpjeguar se regjistrimi i pasurisë është kryer mbi bazën të formularit nr. 1, por në këtë akt nuk ka pasur të pasqyruar asnjë të dhënë tjetër në lidhje me ndërtesën, si numrin e kateve apo çdo të dhënë tjetër ndërtimore, përveç sipërfaqes së bazës së ndërtimit. Këto të dhëna janë në këtë format për të gjitha fshatrat e administruara nga ASHK-ja Kuçovë. Akti ligjor që u regjistrua banesa në fshat si për gjithë fermerët është formulari nr. 1, bazuar në VKM-në nr. 432, datë 14.8.1995.

Në lidhje me analizën financiare subjekti ka paraqitur pretendime për disa elemente, të cilat vijnë më poshtë.

iii. Për shpenzimet financiare të ndërtimit të shtëpisë dykatëshe në fshatin T, Kuçovë

¹⁹Shpenzimet e jetesës për periudhën para vitit 2000, janë përlloritur në masën 66% të të ardhurave, bazuar në vendimin e KPA-së për N. K, datë 26.7.2019, por duke i zbritur edhe shpenzime për zërin “fruta-perime” nga shporta e ushqimeve.

Subjekti ka shpjeguar se në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2003, ka deklaruar shtëpi banimi e ndërtuar mbi truallin me sip. 200 m², në vlerën 1.200.000 lekë. Kjo shumë përfaqëson shumën reale që është shpenzuar prej tij për ndërtimin e shtëpisë dykatëshe.

Subjekti ka shpjeguar se vlera e deklaruar në deklaratën *Vetting* në shumën 3.500.000 lekë, përfaqëson çmimin e tregut të shtëpisë, sa kushtonte kjo pasuri në vitin 2016, referuar kjo VKM-së nr. 815, datë 9.12.1996, “Për miratimin e vlerave mesatare vjetore të apartamentit tip, në tregun e lirë dhe vlerës së koeficientit ‘K’ me koston mesatare të shfrytëzimit” që për rrethin Kuçovë është 16.357 lekë/m².

Subjekti ka kërkuar nga Komisioni, që në analizën financiare, të llogaritet shuma se sa ka shpenzuar realisht për ndërtimin e saj, pra shumën prej 1.200.000 lekësh, sipas deklaramit të tij të parë në vitin 2003 dhe jo sa është vlera e tregut e shtëpisë në momentin e deklarimit të saj në deklaratën *Vetting*.

iv. Për të ardhurat e realizuara nga bujqësia

Subjekti ka pretenduar se me ligjin nr. 7501/1991, nëpërmjet AMTP-së nr. ***, ka përfituar tokë bujqësore në fshatin T, në të cilën ka ushtruar aktivitet bujqësor në vite dhe ka realizuar të ardhura në mënyrë periodike nga ky aktivitet. Subjekti shpjegoi se këto të ardhura i ka deklaruar rregullisht në vite në DPV-të përkatëse, ka paguar taksën e tokës, si dhe ka provuar me dokumentacion nga institucionet shtetërore që ka pasur aktivitet bujqësor. Me këtë arsytim i ka kërkuar Komisionit, që në analizën financiare të përfshijë të ardhurat e realizuara nga bujqësia si të ardhura të ligjshme, të cilat duhet të merren në konsideratë nga Komisioni dhe të përfshihen në analizën financiare.

v. Në lidhje me shpenzimet e jetesës të llogaritur nga Komisioni

Subjekti, sikurse ka pretenduar dhe gjatë hetimit dhe në prapësime, shpjegoi se së bashku me familjen e tij ka banuar gjatë gjithë jetës në fshatin T, Kuçovë. Duke pasur në vëmendje këtë fakt, shpenzimet e jetesës së familjes së tij nuk duhet të llogariten si të një familjeje që jeton në qytet, por si një familje që jetesa në fshat, për shkak të tokës që kanë disponuar, i ka ndihmuar ekonomikisht nisur nga prodhimi vetë i produkteve të shportës ushqimore. Subjekti ka kërkuar, që në analizën financiare të kryer nga Komisioni, t’i ulen shpenzimet e jetesës duke pretenduar se për periudhën 1994 – 2000, Komisioni duhet të marrë në konsideratë që subjekti dhe familja e tij jetonin në fshat dhe nuk mund të përlllogariten në masën 66% të të ardhurave bazuar në vendimin e Kolegjit, siç veprohet me subjektet e tjera. Subjekti ka pretenduar se Komisioni, në përlllogaritjet e shpenzimeve të jetesës, ka zbritur nga shporta e ushqimeve shpenzimet për fruta – perime, ndër vite, bazuar në të dhënat statistikore të publikuara nga INSTAT-i.

Subjekti ka kërkuar që Komisioni të marrë në konsideratë që shpenzimet jetike nuk i kanë mbuluar me të ardhurat nga pagat, por me të ardhurat nga prodhimet bujqësore (perimet të prodhuara në tokën e tyre, bagëtitë dhe pulat të mbajtura në shtëpi, etj.), duke mbuluar të gjitha nevojat familjare për shpenzimet jetike dhe jo vetëm për zërin “fruta-perime”. Subjekti ka shpjeguar se kanë siguruar me punën e tyre në fshat mishin, vezët, qumështin dhe nënproduktet e tij dhe të gjitha nevojat për drithëra, fruta dhe perime të përfshira në shportën e ushqimeve.

Bazuar në të dhënat statistikore të publikuara nga INSTAT-i, ndër vite, nevojat për ushqime janë siguruar nga ekonomia vetjake në tokën bujqësore, bagëtitë dhe pulat që në fshat i kanë disponuar gjithmonë.

Subjekti ka argumentuar se nëse do të merren në konsideratë pretendimet e tij, sikurse është shpjeguar më sipër, analiza financiare do të rezultojë me gjendje pozitive.

Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij sa më sipër në lidhje me prodhimin e produkteve bazë për t'u ushqyer, ka depozituar aktet vijuese:

- shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2021, të Bashkisë Kuçovë me përshkrimin “aktekspertimi vlerësues i siguruar nga toka bujqësore dhe blegtoria” për familjen Nazmi Troka;
- vërtetimin datë 15.10.2021, lëshuar nga kryeplaku i fshatit T, Kuçovë, sipas të cilit rezultoi se: “Familja e Nazmi Trokës jeton në fshatin T, Kuçovë dhe ka të ardhura nga blegtoria dhe tokat bujqësore”;
- deklaratën noteriale datë 15.10.2021, lëshuar nga veterineri që ka shërbyer për mbarëshkrimin e lopëve dhe shpendëve.

Subjekti ka pretenduar se shpenzimet e jetesës së tij nuk mund të jenë të njëjta me shpenzimet e shportës së një individi, që banon në qytet dhe i ble produktet e shportës.

2.8 Vlerësimi i Komisionit

Pas kalimit të barrës së provës, Komisioni analizoi shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti:

i. Në lidhje me pretendimet që shtëpia ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1994, Komisioni arsyeton se qëndrimet e subjektit, në lidhje me periudhën e ndërtimit, janë kontradiktore pasi në deklaratën *Vetting* ka deklaruar shtëpi banimi 2 kate, me sip. 99 m²/kati, filluar ndërtimi para vitit 1991 dhe përfunduar në vitin 2000, bashkë me anekset (pa u specifikuar katet e banesës). Ky deklaram i subjektit për periudhën e ndërtimit të shtëpisë është konfirmuar prej tij edhe në shpjegimet e dhëna në përgjigjet e pyetësorit, të ardhura në datën 24.4.2020.

Për pasojë, Komisioni nuk mori në konsideratë pretendimet e subjektit se ndërtimi i shtëpisë ka përfunduar në vitin 1994, pasi nuk mbështeten mbi ndonjë provë konkrete.

ii. Në lidhje me dokumentacionin që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë, shtëpi 2 kate, rezultoi se pretendimet e subjektit janë konfirmuar edhe nga përgjigjja e ASHK-së Vendore Kuçovë²⁰, ku referohet se pasuria arë + truall + 99 m² ndërtesë, në pronësi të familjes bujqësore me përfaqësues shtetasin Nazmi Troka, është përfituar në bazë të AMTP-së nr. **, sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për Tokën”, i ndryshuar.

Ndërtesa në pronësi të subjektit është përfituar në zbatim të VKM-së nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, nga ku në zbatim të kësaj VKM-je ka dalë edhe formulari nr. 1, për trojet dhe ndërtesat, në të cilat subjekti i rivlerësimit figuron i regjistruar me numër rendor **. ASHK-ja Kuçovë ka saktësuar se në formularin 01 nuk ka të dhëna dhe rubrikë për përcaktimin e elementëve të tjerë, për sa i përket

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2021.

numrit të kateve të ndërtesës, duke konfirmuar se këto janë aktet, të cilat kanë shërbyer për regjistrimin e fillestar të kësaj pasurie.

Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se nuk ngrihen dyshime për regjistrimin e kësaj pasurie në ASHK-në Kuçovë.

iii. Në lidhje me pretendimet e subjektit, sipas të cilit Komisioni duhet të përlllogarisë në analizë financiare koston e shtëpisë sipas vlerës së deklaruar në DPV-në e vitit 2003, në shumën prej 1.200.000 lekësh. Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk mund të pranohet kur subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar një vlerë tjetër të pasurisë.

Trupi gjykues arsyetoi se për një vlerësim sa më objektiv të çështjes, duke përdorur të njëjtin standard të përdorur edhe në raste të tjera të ngjashme, për efekt të llogaritjes së kostos së ndërtimit të shtëpisë dykatëshe, Komisioni ka vendosur të përlllogarisë koston e ndërtimit referuar çmimeve sipas Entit Kombëtar të Banesave, ku referuar këtyre çmimeve, për periudhën 1994 – 2000, ndërtimi i shtëpisë rezulton të ketë kushtuar në shumën 3.105.538 lekë. Kjo vlerë është përfshirë në tabelën e analizës financiare, si kosto e ndërtimit të shtëpisë dykatëshe.

iv. Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga bujqësia, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk paraqiti prova dhe fakte të reja që të provonte të kundërtën e rezultateve të hetimit. Subjekti provoi se kishte paguar taksën e tokës vetëm për vitet 2004 – 2006, si dhe nga 2011 e në vijim sipas vërtetimit të lëshuar nga Njësia Administrative P, Kuçovë. Të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga aktiviteti bujqësor mbetën në nivel deklarativ, të pambështetura në dokumentacion. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë se kishte përfituar të ardhura nga shitjet e prodhimeve bujqësore apo pemëtaria, të palët e treta për periudhën 1991 – 2000. Për pasojë, subjekti nuk provoi bindshëm të ardhurat e ligjshme që kishte krijuar nga aktiviteti bujqësor. Për këtë shkak, shumat e pretenduara si të përfituara nga aktiviteti bujqësor nuk janë përfshirë në analizën financiare.

v. Në lidhje me shpenzimet e jetesës, mbështetur në provat e sjella nga subjekti, Komisioni mori në konsideratë pretendimet e tij se së bashkë me familjen ka banuar gjithë jetën në fshat, si dhe duke disponuar sipërfaqe të madhe toke, në një formë, këtë tokë e ka vënë në funksion të ekonomisë familjare. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës nuk arriti t'i provonte Komisionit se kishte krijuar të ardhura nga bujqësia, por me provat e reja që solli, bindi Komisionin se nga ky aktivitet kishte mundur të ndihmonte ekonominë e tij familjare.

Në rezultat e hetimit, në zërin “shpenzime të jetesës”, janë zbritur vetëm fruta-perimet, të cilat afërsisht janë në masën rreth 20% të shportës së ushqimeve. Duke marrë në konsideratë pretendimet e paraqitura, Komisioni pranoi shpjegimet e subjektit se prodhimet ushqimore, fruta-perime, bulmetin, vezët, qumështi, mishi etj., janë prodhuar prej familjes së tij bujqësore dhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni i janë ulur shpenzimet e jetesës sipas shportës, bazuar në të dhënat e publikuara nga INSTAT-i, të cilat janë në masën rreth 50% të shpenzimeve.

Analiza financiare pas prapësimeve, mbi burimet e ligjshme për ndërtimin e shtëpisë në fshatin T, Kuçovë, duke u bazuar në kostot e ndërtimit sipas referencave të EKB-së, si dhe

duke zbritur nga shpenzimet e jetesës shportën ushqimore sa më sipër, ka rezultuar sipas tabelës vijuese:

Përshkrimi	Periudha 1994 – 2000
Të ardhura të subjektit nga pagat për vitet 1994 – 2000	1.858.822
Të ardhura të bashkëshortes nga pagat për vitet 1996 – 2000	486.649
Të ardhura total	2.345.471
Shpenzime jetese pa shportën e ushqimeve	774.005
Shtëpi në Kuçovë	3.105.538
Rezultati financiar	- 1.534.073

Trupi gjykues, për këtë pasuri, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për ndërtimin e shtëpisë dykatëshe, për periudhën 1994 – 2000, në shumën 1.534.073 lekë.

Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e shtëpisë, në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar të jetë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e shtëpisë.

3. Apartament²¹ banimi me sip. 64 m², blerë më 31.10.2014, në rrugën “Komuna e Parisit”, kompleksi “K”, Tiranë

Vlera e deklaruar: 67.000 euro.

Pjesa në përqindje: në bashkëpronësi.

Burimi i krijimit: shuma 24.970 euro (4.314.361 lekë), paguar nga depozita në “Raiffeisen Bank” datë 31.10.2014;

hua në shumën 25.000 euro, marrë shtetasit A.M, transaksion bankar i datës 27.10.2014, nga BKT-ja;

shuma 5.700 euro, paguar nëpërmjet shumave si depozitë bankare, në emër të vajzës B.T, në “Intesa Sanpaolo Bank”, transaksion i datës 31.10.2014;

shuma 11.330 euro, shlyer nga gjendja *cash* me të ardhura të siguruara gjatë vitit 2014.

Deklarimi në DPV²²: depozitat bankare, huaja dhe kursimet *cash*.

²¹Për këtë aset subjekti ka paraqitur: akt noterial nr. ***, datë 31.10.2014, për zgjidhjen vullnetare të kontratës së porosisë nr. ***, datë 25.2.2013, me palë D.H, Nazmi Troka, dhe shoqëria “H” sh.p.k.; kontratë porosie datë 25.2.2013, me palë sipërmarrëse shoqëria “H” sh.p.k. dhe palë porositëse D.H, për porositje apartamenti me sip. 64 m², vlera 57.600 euro; kontratë huadhënieje nr. ***, datë 27.10.2014 me palë huadhënëse A.M dhe palë huamarrëse Nazmi Troka, vlera 25.000 euro; kërkesë për transaksion datë 27.10.2014, nga BKT-ja nga shtetasit A. M, kalim për blerje apartamenti në “Raiffeisen Bank” në favor të Nazmi Troka, vlera 25.000 euro; vërtetim të ardhurash për shtetasin A. M, periudha 2002 – 2015, vlera totale 161.682 euro (në greqisht); kontratë depozite në BKT, datë 17.1.2013, për shtetasit A dhe E.M, shuma e depozituar 7.600.000 lekë; librezë banke NBG dhe statement i shtetasve A dhe E.M (në greqisht); njoftim debitimi datë 31.10.2014, nga “Raiffeisen Bank”, me urdhërues Nazmi Troka dhe përfitues D.H, vlera 4.314.361 lekë; mandat tërheqje datë 31.10.2014, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, nga vajza B.T, vlera 5.700 euro.

²²DPV-ja e vitit 2014.

Mënyra e fitimit: blerë me aktin nr. ***, datë 31.10.2014, për zgjidhjen vullnetare të kontratës së porosisë.

Statusi aktual: pasuri e paregjistruar ende në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ASHK-të Tirana Rurale 1²³ dhe 2²⁴, Tirana Jug²⁵ dhe Veri²⁶ nuk kanë konfirmuar pasuri të regjistruara në emër të subjektit në qytetin e Tiranës.

OSHEE-ja²⁷ nuk ka konfirmuar asnjë kontratë furnizimi të regjistruar për apartamentin e blerë nga subjekti në Tiranë.

UKT-ja²⁸ informon se nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata shërbimi në Tiranë, në emër të subjektit apo personave të tjerë të lidhur.

Subjekti ka saktësuar²⁹ se: *“... nuk ka kaluar pronësia me kontratë shitjeje definitive për shkak se kur është kryer veprimi juridik akt noterial nr. ***, datë 31.10.2014, pallati nuk ishte regjistruar në emër të shoqërisë ‘H’ sh.p.k. në ish-ASHK Tiranë. Gjithsesi, subjekti ka shpjeguar se apartamenti është pasuri e deklaruar në pronësinë e tij dhe do të kryejë në vijim veprimet juridike dhe ato administrative të kalimit definitiv të kësaj pasurie”.*

3.2 Analiza e fakteve

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti ka rezultuar se apartamenti me sip. 64 m², fillimisht, ishte porositur me kontratën e porosisë së datës 25.2.2013, nga shtetasi me inicialet D. H. dhe me palë sipërmarrëse shoqërinë “H” sh.p.k., në çmimin 57.600 euro.

Në vijim, në aktin noterial nr. ***, datë 31.10.2014, për zgjidhjen vullnetare të kontratës së porosisë nr. ***, datë 25.2.2013, me palë shtetasin me inicialet D. H., Nazmi Troka, dhe shoqërinë “H” sh.p.k., shtetasi me inicialet D. H., heq dorë nga kontrata e porosisë nr. ***, datë 25.2.2013, me të cilën ka pronotuar apartamentin me sip. 64 m², në rrugën “Komuna e Parisit”, Tiranë, me vlerë 57.600 euro në shoqërinë “H” sh.p.k. dhe këtë apartament deklarohet se ia ka shitur shtetasit Nazmi Troka me të njëjtin çmim + 9.400 euro për punimet e bëra, pra vlera totale 67.000 euro, e cila është likuiduar totalisht nga shtetasi Nazmi Troka. Kontrata përfundimtare e shitjes do të lidhet mes shoqërisë “H” sh.p.k. dhe shtetasit Nazmi Troka.

Ka rezultuar se subjekti, për të shlyer shumën e blerjes së apartamentit, ka nënshkruar një kontratë huadhënieje nr. ***, datë 27.10.2014 me palë huadhënëse A.M dhe palë huamarrëse shtetasin Nazmi Troka, shuma 25.000 euro, pa interes, me afat kthimi datë 31.12.2019 me këste çdo fundvit në shumën 5.000 euro.

²³Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2019.

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 23.10.2019.

²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2019.

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 23.10.2019.

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 15.10.2021.

²⁸Shkresë nr. K*** prot., datë 9.10.2019.

²⁹Në përgjigjet e pyetësorit ardhur më 8.10.2021.

Bashkëlidhur akteve rezultoi edhe një transfertë në BKT, datë 27.10.2014, nga shtetasi A. M, me përshkrimin “kalim për blerje apartamenti në ‘Raiffeisen Bank’ në favor të shtetasit Nazmi Troka”, në vlerën 25.000 euro.

Gjithashtu, për blerjen e pasurisë në dosje rezultojnë aktet:

- njoftim debitimi datë 31.10.2014, në “Raiffeisen Bank”, me urdhërues shtetasin Nazmi Troka dhe përfitues shtetasin me initiale D. H., vlera 4.314.361 lekë;
- mandat tërheqje datë 31.10.2014, në “Intesa Sanpaolo Bank”, nga vajza e subjektit B.T, në shumën 5.700 euro.

3.3 Komisioni analizoi burimet e krijimit për pasurinë apartament, të deklaruara në deklaratën *Vetting* si vijon:

- i. depozita në shumën 24.970 euro (4.314.361 lekë), në “Raiffeisen Bank”, paguar më 31.10.2014;
- ii. hua në shumën 25.000 euro, marrë shtetasit A.M, transaksion bankar i datës 27.10.2014, nga BKT-ja;
- iii. depozita bankare, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të vajzës B.T, transaksion i datës 31.10.2014, paguar në shumën 5.700 euro;
- iv. nga gjendja *cash* në vitin 2014, shlyer në shumën 11.330 Euro.

i. Depozita në shumën 24.970 euro (4.314.361 lekë) në “Raiffeisen Bank”

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume, subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka shpjeguar³⁰ se: *“Burimi i kësaj depozite është krijuar nga kursimet e pagës sime dhe bashkëshortes dhe të ardhurat nga toka bujqësore dhe interesat bankare”*.

Historiku i depozitës dhe burimi i krijimit

Nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se kjo depozitë është hapur nga viti 2003 e në vijim. Subjekti ka deklaruar që në vitin 2003 depozitën dhe shtesat në vite.

Subjekti ka depozituar një shkresë nga “Raiffeisen Bank”, ku jep informacion mbi gjendjet për periudhën 2004 - 2005. Nga informacioni i administruar në shkresat e “Raiffeisen Bank” duket se subjekti i ka deklaruar saktë shtesat dhe gjendjet e depozitave.

Në lidhje me burimin e tyre, subjekti ka deklaruar në vite se për krijimin e këtyre shumave kanë shërbyer të ardhurat nga paga e tij, të ardhurat nga paga e bashkëshortes, si dhe të ardhurat e siguruara nga aktiviteti bujqësor i pemëtarisë. Në DPV- në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar pakësim të depozitës për blerjen e apartamentit në Tiranë.

Nga verifikimi i llogarisë bankare ka rezultuar se në datën 31.10.2014 subjekti i ka transferuar shitësit të apartamentit shumën 4.314.361 lekë me përshkrimin “kalim diference sipas marrëveshjes datë 31.10.2014”.

Nga hetimi i Komisionit duket se:

- Subjekti i ka deklaruar saktë shtesat dhe gjendjet e depozitave në bankë, ndër vite.

³⁰Në përgjigjet e pyetësorit të datës 22.7.2021.

- Subjekti i ka kaluar me transfertë fondet në datën që ka lidhur kontratën e blerjes së apartamentit.

Analiza financiare, për të vlerësuar mundësitë e subjektit për krijimin e kësaj depozite, gjendet në tabelën përmbledhëse (në faqen 37 të vendimit) për periudhën 2003 – 2014, ku janë analizuar burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

ii. Hua në shumën 25.000 euro, marrë shtetasit A.M

Komisioni analizoi burimet e ligjshme të huadhënësit që kanë shërbyer për dhënien e kësaj huaje për shumën 25.000 euro, sipas transaksionit bankar të datës 27.10.2014, nga BKT-ja.

Subjekti, në përgjigje të pyetësorit³¹, ka deklaruar se: *“Kjo shumë është kaluar nga llogaria e huadhënësit A.M që ka në BKT tek llogaria e huamarrësit Nazmi Troka në ‘Raifaissen Bank’ në datën 27.10.2014 me afat shlyerje 5 vite. Për këtë veprim kam lidhur edhe kontratën noteriale të huas datë 27.10.2014 me huadhënësin A.M dhe huamarrësin Nazmi Troka. Theksoj se shtetasi A.M (Kunati) që nga viti 1992 ka emigruar në shtetin grek dhe pas vitit 1998 me dokumente të rregullta jeton si rezident familjarisht në qytetin e Patrës, Greqi. A.M ka qenë në marrëdhënie pune rregullisht dhe ka punuar dhe punon kryesisht në ndërtim në punë formale, pa munguar dhe puna joformale. Jo vetëm ai por edhe familjarët e tij kanë qenë në marrëdhënie pune si me rregulla, por dhe informal”.*

Komisioni ka administruar të gjithë dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e ligjshëm, i cili ka rezultuar si vijon:

- librezë origjinale e llogarisë bankare në emër të shtetasit A.M, si dhe statementi i llogarisë për periudhën 19.3.2010 – 30.6.2014. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë duket se huadhënësi ka pasur një depozitë ekzistuese në Bankën Kombëtare Greke në shumën 54.000 euro, që nga viti 2010. Duket se kjo shumë është tërhequr *cash* në vitin 2011;
- një kontratë çelje depozite në BKT, në emër të shtetasit A.M, në datën 17.1.2013, në shumën 7.600.000 lekë;
- shkresë lëshuar nga Autoriteti Tatimor i shtetit grek, ku listohen të ardhurat e siguruara nga shtetasi A.M në vitet 2002 – 2015, në shumën totale 161.682 euro;
- shkresë më 23.12.2019 nga autoriteti përkatës në shtetin grek (sigurime shoqërore) në lidhje me ardhurat e djalit të huadhënësit A. M për vitet 2007 – 2014, në shumën rreth 24.652 euro.
- **Komisioni hetoi në lidhje me ndonjë investim në pasuri të paluajtshme në Shqipëri** nga huadhënësi apo familjarë të tij dhe nga verifikimi në sistemin *online* të ASHK-së ka rezultuar se shtetasi A.N.M ka blerë një apartament në shumën 3.000.000 lekë në vitin 2004, si dhe një garazh në shumën 500.000 lekë në vitin 2005, të dyja pasuritë me vendndodhje në qytetin e Beratit.

Sa më sipër, Komisioni analizoi mundësinë për dhënien e huas duke marrë në konsideratë:

- të ardhurat totale të ligjshme, referuar dokumentacionit lëshuar nga shteti grek për shtetasit A dhe A.M për vitet 2002 – 2014 (bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti);

³¹Ardhur në datën 24.4.2020.

- shpenzimet jetike në shtetin grek për periudhën 2002 – 2014 bazuar në të dhënat statistikore të Eurostat (<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/>);
- shpenzimet për investimet në pasuri të paluajtshme, si dhe depozitat janë përlllogaritur sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni.

Tabela e të dhënave, ndër vite për periudhën 2002 - 2012, lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet jetike në shtetin grek

Pershkrimi	2002-2012
Te ardhurat A. M	154 045
Te ardhurat A. M (I biri)	24 651
Te ardhura total ne euro	178 696
Te ardhura total ne leke	23 505 112
Shpenzime jetese euro	190 799
Shpenzime ne leke	25 188 344
Te ardhura - shpenzime	- 1 683 231

Analiza financiare për periudhën 2002 – 2014 për mundësinë e dhënies së huas

Përshkrimi	Periudha 2002 – 2014
Të ardhura total	23 505 112
Shpenzime jetese 12 vjet për tre persona minimumi	25 188 344
Blerje apartamenti në Berat më 20.9.2004	3 000 000
Blerje garazhi në Berat më 10.6.2005	500 000
Depozitë në BKT	7 600 000
Dhënie hua subjektiv	3 502 750
Mundësia financiare	-16 285 981

Nga analiza financiare e huadhënësit duket se huadhënësi dhe familja e tij nuk kanë pasur mundësi me burime të ligjshme për dhënien e huas në shumën 25.000 euro, pasi rezultojnë me balancë negative në shumën 16.285.981 lekë.

Komisioni hetoi lidhur me ndonjë rast të mundshëm konflikti interesi, duke kërkuar informacion në Gjykatën e Apelit Vlorë³² dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat³³ për procese gjyqësore të zhvilluara nga subjekti me palë A, E dhe A.M, të cilët kanë konfirmuar se pranë këtyre institucioneve, këta shtetas nuk kanë qenë palë në procese gjyqësore.

Në lidhje me burimet e ligjshme të huadhënësit, nga hetimi i Komisionit rezultoi se huadhënësi nuk ka pasur burime të ligjshme nga aktiviteti i tij në shtetin grek për të përballuar shpenzimet jetike, si dhe në të njëjtën kohë për të kursyer dhe dhënë hua subjektivit të rivlerësimit.

iii. Shuma 5.700 euro, transaksion i datës 31.10.2014, nga depozita bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të vajzës B. T

³²Shkresë nr. *** prot., datë 27.9.2021, si dhe shkresa depozituar nga subjekti me nr. *** prot., datë 7.10.2021.

³³Shkresë nr. *** prot., datë 30.9.2021, si dhe shkresa depozituar nga subjekti me nr. *** prot., datë 7.10.2021.

Komisioni e pyeti subjektin në lidhje me mundësinë e krijimit të shumës 5.700 euro, nga vajza e tij, depozitë në emër të B.T, i cili ka shpjeguar³⁴ se: “Vajza B. T nuk ka siguruar asnjëherë të ardhura për të kursyer shumën 5.700 euro. Sqaroj se në vitin 2013 vajza B.T mbaroi shkollën e mesme dhe konkurroi për studimet e larta në fushën e mjekësisë në Padova, Itali.

Në dokumentacionin që kërkonte kjo shkollë, mes të tjerave, përfshinte edhe një kërkesë që kishte të bënte me garancinë pasurore për studime në emër të aplikantit (në rastin konkret në emër B. T). Nisur nga ky fakt, në datën 12.7.2013 i kam dhënë vajzës B.T shumën e kërkuar si garanci nga shkolla dhe kjo shumë u mbyll nga vetë vajza në emrin e saj në ‘Intesa Sanpaolo Bank’. Vajza nuk shkoi me studime në Itali, por përfundoi studimet për mjekësi në Universitetin e Mjekësisë Tiranë në vitin 2019. Kur bleva banesën në Tiranë për të plotësuar vlerën e banesës vajza B.T tërhoqi shumën 5.700 euro më 31.10.2014, pasi vetëm ajo kishte të drejtë t’i tërhiqte nga banka, shumë e cila u përdor për blerjen e banesës. Këtë situatë financiare e kam deklaruar edhe në deklaratën periodike qysh në vitin 2014, dorëzuar në ILDKPKI, datë 25.3.2014, ku kam deklaruar: ‘Citoj përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit: depozitë në ‘Intesa Sanpaolo Bank’. Burimi i të ardhurave nga paga ime, e bashkëshortes dhe nga të ardhurat nga prona private pemëtari në fshatin T, Komuna P, Kuçovë. Kjo depozitë është në emër B.T, vënë për garanci studimi, në shumën 5.750 euro”.

Nga verifikimi i llogarive bankare rezultoi se vajza e subjektit ka çelur një depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 12.7.2013, ku është depozituar *cash* shuma 6.500 euro, nga ku në datën 31.7.2013 është transferuar për pagesë garancie studimesh në shtetin italian. Kjo shumë është rimbursuar, kthyer në llogari, në datën 17.10.2014. Më pas është tërhequr në datën 31.10.2014. Kjo llogari është mbyllur në datën 24.11.2014.

Rezultoi e provuar se në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar çeljen e kësaj depozite në emër të vajzës B.T, vënë si garanci studimi. Subjekti ka deklaruar, gjithashtu, burimin e krijimit të saj me të ardhurat nga pagat e subjektit e bashkëshortit dhe nga pemëtaria në fshatin T, Kuçovë.

➤ **Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.**

iv. Gjendja *cash* deri në vitin 2014, me të cilat është kryer pagesa në shumën 11.330 euro

Komisioni verifikoi deklaratat periodike vjetore, nga ku rezultoi se subjekti ka deklaruar rregullisht gjendjen *cash*, ndër vite. Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore duket se subjekti ka kryer pagesën me gjendjen *cash*, të akumuluar në vite.

Analiza financiare, për të vlerësuar mundësitë e subjektit për krijimin e gjendjes *cash*, gjendet në tabelën përmbledhëse (në faqen 37 të vendimit), për periudhën 2003 – 2014, ku janë analizuar burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

3.4 Komisioni analizoi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e depozitave dhe të kursimeve *cash*, burime këto të deklaruar për blerjen e apartamentit, për periudhën 2003 - 2014

³⁴Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur në datën 24.4.2020.

Analiza financiare e kryer nga Komisioni përfshin të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit, bashkëshorten dhe fëmijët. Për analizimin e kursimeve *cash* të subjektit të rivlerësimit u morën në konsideratë deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat vjetore të interesave pasurore. Për likuiditetet bankare janë verifikuar të gjitha llogaritë e subjektit dhe personave të lidhur, duke marrë në konsideratë gjendjet në fund të çdo viti, bazuar në dokumentacionin përkatës.

3.5 Shpenzimet

a. Në lidhje me shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë llogaritur bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së.
- Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit, bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje, nëpërmjet të dhënave të sistemit *TIMS* për subjektin e rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan/plotësuan me deklaratimet e subjektit.
- Shpenzimet për blerje automjeti u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, si dhe në dokumentacionin e administruar nga institucionet përkatëse.
- Shpenzimet për shkollim u bazuan në dokumentacionin³⁵ e administruar në dosje dhe deklaratimet e subjektit.
- Shpenzimet për këstet e kredisë në “Fondin B”³⁶, janë përlllogaritur në bazë të shkresës nr. *** prot., datë 10.10.2019.
- Në lidhje me shpenzimet e mobilimit të apartamentit në Tiranë, subjekti ka shpjeguar³⁷ se nuk ka shpenzime, pasi apartamenti ishte i mobiluar me të gjithë orenditë dhe kjo është shprehur edhe në aktin noterial nr. ***, datë 31.10.2014.

b. Në lidhje me të ardhurat pagat + interesat bankare

Të ardhurat nga pagat janë pasqyruar *neto* sipas dokumentacionit të administruar në dosjen hetimore të subjektit nga institucionet³⁸ respektive:

- Të ardhura: për periudhën 23.10.1993 – 1.1.1994, ndihmës gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë, për periudhën 2003 – 23.10.2013, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe për periudhën 23.10.2013 – 31.12.2014, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, në vlerën 11.105.841 lekë.

³⁵Vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016, i Kolegjit të Vajzave “M.A”, ku vërtetohet se B.T ka qenë nxënëse në këtë shkollë, në vitet 2010 – 2013, për të cilën është paguar shuma 735.750 lekë; vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016, i shkollës jopublike 9-vjeçare dhe të mesme “T. O”, ku vërtetohet se për shkollimin e E.T, në vitet 2011 – 2014, është paguar shuma totale 863.100 lekë; vërtetim nr. *** prot., datë 4.2.2019, i shkollës “T.O.E”, ku vërtetohet se për shkollimin e J.T, në vitet 2016 – 2017, është paguar shuma totale 518.700 lekë (për vitin 2016 paguar 342.700 leke dhe për vitin 2017 paguar 176.000 lekë).

³⁶Subjekti ka marrë një kredi prej 500.000 lekësh për investim në vitin 2001.

³⁷Në përgjigjet e pyetësorit ardhur në datën 8.10.2021.

³⁸Përveç vërtetimeve nga gjykatat për subjektin dhe bashkëshorten është administruar edhe informacion nga ISSh-ja, e cila ka depozituar informacion mbi të ardhurat e përfituara nga subjekti si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, për periudhën kohore maj 2012 – tetor 2013. Në vijim, ky subjekt është punësuar në Gjykatën e Apelit Vlorë deri në gusht të vitit 2019. ISSh-ja ka depozituar informacion në lidhje me të ardhura të përfituara nga zj. P.T (bashkëshortja e subjektit), si punonjëse në Drejtorinë Arsimore Kuçovë për periudhën muaji janar 2012 – gusht 2019.

- Të ardhura nga paga e bashkëshortes si mësuese, në shkollën “** Nëntori”, Kuçovë, për periudhën 2003 – 2014, në vlerën 4.695.420 lekë.
- Të ardhura nga interesat bankare të depozitave, për periudhën 2004 – 2014, në shumën totale 929.481 lekë.

c. Të ardhurat e deklaruara nga pemëtaria

Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “Të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore (fruta dhe perime) siguruar nga toka bujqësore ndodhur fshati T, Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë me sip. 8.000 m² në bashkëpronësi të familjes bujqësore, kryesisht pemëtari, për periudhën 1992 – 2016, në vlerën 7.000.000 lekë”.

Subjekti rezulton i regjistruar me NIPT L***O, datë 15.11.2016, në emër të shtetasit Nazmi Troka, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat”.

ILDKPKI-ja, për të ardhurat nga pemëtaria, ka konstatuar se:

- Mungon dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara nga shitja e produkteve bujqësore, për periudhën 1992 – 2016, në shumën 7.000.000 lekë.
- Deklarim i pasaktë lidhur me të ardhurat e deklaruara nga shitja e produkteve bujqësore për periudhën 1992 – 2016, në shumën 7.000.000 lekë, pasi referuar deklaratave të interesave private ndër vite, të ardhurat e deklaruara për periudhën 2003 – 2016 janë rreth 7.200.000 lekë, pra, rezulton mospërputhje për kohën e deklaruar.

i. Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga verifikimi i shumave të deklaruara në DPV-të vjetore, për periudhën 2003 – 2016, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar shumën totale prej 7.152.000 lekësh.

Në lidhje me aktivitetin bujqësor dhe të ardhurat e gjeneruara prej këtij aktiviteti, subjektit i është kërkuar nga Komisioni që të depozitojë dokumente provues për të ardhurat e gjeneruara nga shitja e produkteve bujqësore, si dhe të japë shpjegime kush ka qenë i përfshirë në punët e bujqësisë.

Për të ardhurat e krijuara nga shitja e produkteve bujqësore (fruta dhe perime), subjektit i është kërkuar të japë informacion dhe të dokumentojë si vijon:

a) për të ardhurat e krijuara për çdo vit që nga viti 1992, të specifikohen dhe dokumentohen:

- shitjet në vlerë dhe në sasi të produkteve duke specifikuar produktet;
- çmimet e shitjes së produkteve;
- kostot për ambalazhimin e produkteve transporti shpenzimet për këtë aktivitet - sasinë etj.

b) informacion të detajuar, në lidhje me të ardhurat e krijuara nga bujqësia apo pemëtaria, sipas viteve të shoqëruar me dokumentacionin, ku të provohet se janë paguar tatimet në kuptimin e pikës 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti, në përgjigje të pyetësorit ka shpjeguar se: “Referuar shkresës nr. *** prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë, njëherë provohet fakti se kam shfrytëzuar tokën bujqësore me sipërfaqe 8 dynym të ndodhur në fshatin T, Njësia

Administrative P, Bashkia Kuçovë, duke kultivuar kryesisht pemëtari nga, ku sipas këtij akti kam siguruar të ardhura.

*Më tej, me hyrjen në fuqi të ligjit për pagimin e taksave mbi 'Tokën bujqësore', bashkëngjitur gjendet vërtetimi nr. *** prot., datë 21.10.2016 dhe nr. ***, datë 14.4.2020, të Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë, me të cilën provohet fakti se janë derdhur detyrimet.*

Lidhur me faktin se kush është përfshirë në punët e bujqësisë, sqaroj se duke qenë se kam jetuar dhe vazhdoj të jetoj familjarisht në fshatin T, Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë, gjatë gjithë kohës kryesisht, unë, por dhe familja ime në fundjavë dhe pasditeve jemi marrë dhe me kujdesin e punëve për të kultivuar dhe shitur prodhimet kryesisht fruta dhe më pak perime.

Lidhur me sa kërkoni për pagimin e tatimeve mbi të ardhurat e siguruara nga shitja e prodhimeve bujqësore, sqaroj se fermeri, paguan vetëm tatim mbi pasurinë të cilin e kam paguar rregullisht dhe kjo vërtetohet me vërtetimin e lëshuar nga Njësia Administrative P, ku cilësohet se i kam shlyer të gjitha detyrimet. Në lidhje me këtë pyetje, më tej, sqaroj se nga viti 1992 dhe aktualisht e kemi shfrytëzuar të gjithë tokën bujqësore prej 8 dynym me kultivimin e perimeve, por kryesisht pemëtari me pemë të llojit pjeshkë, kumbulla dhe agrume. Nuk mungojnë në kultivimin e pemëtarisë që unë kultivoj pemë si kajsia, molla, dardha, fiku etj., që kanë dhënë prodhime edhe për tregti.

Gjithashtu, kemi mbjellë për çdo vit, për nevoja familjare prodhime të ndryshme të cilat ulin koston e jetesës së familjes.

Në këto vite kemi marrë prodhime, duke siguruar të ardhura neto në vite që variojnë kryesisht nga shuma 200.000 lekë në vite për vitet 1992 deri në vitin 2000 dhe nga shuma 300.000 lekë deri në 500.000 lekë për periudhën mbas vitit 2000, pasi pemëtaria me rritjen e moshës rriti dhe prodhimin, duke u futur në prodhim të plotë, por ka pasur edhe raste për të ardhura edhe mbi këtë shumë.

Prodhimet janë shitur pa faturë, sipas kërkesave të personave të tretë (kryesisht te tregtarë nga Berati, Vlora dhe Tirana). Nga tregtarët që kam shitur prodhimin evidentoj shoqërinë 'S' sh.p.k. Berat, kryesisht pjeshkën dhe kumbullën për komposto dhe reçel dhe personin fizik 'S. D', me aktivitetet që nga viti 1995 dhe deri më sot në fushën e tregtimit të fruta perimeve.

*Në vitin 2015 hyri në fuqi ligji për pajisjen e fermerit me certifikatë regjistrimi, ligj i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2016 dhe që për ne është zbatuar në vitin 2016. Nisur nga ky ligj unë si fermer jam pajisur me certifikatë regjistrimi në datën 15.11.2016, me NIPT L***.*

Për të krijuar bindjen se kam siguruar të ardhura nga pemëtaria, po iu bashkëlidh disa fatura vetëfurnizimi, lëshuar nga subjektet blerëse, të cilat i disponoj, si dhe transaksionet bankare për këto shitje që kam kryer tek 'G' sh.p.k., datë 24.12.2018, 'S' sh.p.k., datë 19.9.2019 dhe "O.f" sh.p.k., datë 30.12.2019. Këto veprime shitje janë pasqyruar në veprime bankare kryer pranë BKT provuar me printimin e kësaj banke, datë 3.4.2020.

Për të ardhurat që kam siguruar nga shitja e produkteve bujqësore kam deklaruar për çdo vit në ILDKPKI dhe ky i fundit nuk ka kërkuar dokumentacione për këto shitje, çka do na kishte vënë, në pozita pune që të kërkonim fatura shitje qoftë dhe të thjeshta.

Lidhur me bilancin e të ardhurave për vitet 1992 dhe në vazhdim e kam bërë vetë për çdo vit duke kryer kalkulime që konsistojnë në zbritjen nga të ardhurat që rezultojnë nga shitja, shpenzimet e kryera për kultivimin e pemëve dhe perimeve dhe dilte fitimi, pra e ardhura neto. Duke qenë përballë faktit se nuk kam dokumentet e shitjes së prodhimeve bujqësore iu jam drejtuar subjekteve ku kam shitur prodhimet, por ato nuk dispononin dokumentet, pasi në zbatim të ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, nr. 9920, datë 19.5.2008, faturat tatimore dhe regjistrat për efekte tatimore ruhen për 5 vjet.

Lidhur me bilancin për çdo vit nuk munda ta hartoj për shkak të pengesave që hasa në sigurimin e disa dokumenteve nga institucione shtetërore, e private por siç e kam theksuar më lartë të ardhurat kanë qenë ato që variojnë për vitet e para në shumën rreth 200.000 lekë për çdo vit dhe më vonë shumën që variojnë nga 300.000 lekë deri në 500.000 lekë në shumicën e viteve, por ka pasur raste edhe vlera më të mëdha siç konfirmohet në dy vitet e fundit me dokument të rregullt ligjor cituar më lartë. Nëse lind nevoja në një fazë të dytë për pasqyrimin e të ardhurave neto të prodhimeve bujqësore për çdo vit, jam i gatshëm dhe vazhdoj përpjekjen për përpilimin e bilancit.

Për sa i përket tatimeve siç dhe kam shpjeguar më lartë janë paguar provuar me vërtetime leshur në vite nga ish-komuna P, sot Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë”.

*Në lidhje me detyrimet e shlyera për aktivitetin bujqësor, subjekti ka shpjeguar se: “Ka paguar pranë ish-komunës P, Kuçovë, taksë toke bujqësore. Shuma e paguar taksë mbi tokën bujqësore është 2.730 (dymijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë për çdo vit kalendarik vërtetuar me shkresën nr. *** prot., datë 1.4.2021, lëshuar nga Administratori i Njesisë Administrative P, Bashkia Kuçovë, nga viti 2011 dhe në vazhdim.*

Sqaroj se disponoj dhe disa pagesa të kryera para vitit 2011 lidhur me taksën e tokës bujqësore, që është në vlerën 2.800 lekë/vit. Bashkëngjitur tri mandatpagesa për vitet 2005, 2006, 2007, si dhe librezë pagesa taksash ku përveç viteve 2005 – 2007 është dhe pagesa e vitit 2004. Ky është dokumentacioni për taksën e tokës bujqësore. Dua të theksoj faktin se taksë e tokës bujqësore është miratuar me ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002, për sistemin e taksave vendore, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2003.

*Bashkëngjitur këtij sqarimi, shkresa nr. *** prot., datë 1.4.2021, lëshuar nga Administratori i Njesisë Administrative P, Bashkia Kuçovë.*

*Lidhur mbi tatimin për të ardhurat e siguruara nga shitja e produkteve bujqësore sqaroj se jam i regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat me NIPTL ***O, sipas ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014. Për tatimin mbi vlerën e shtuar, VKM-në nr. 953, datë 29.12.2014. Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, Udhëzimit nr. 19 datë 03.11.2014, ‘Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësore dhe qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar’.*

Sipas këtyre akteve ligjore, fermerët regjistrohen në organet tatimore rajonale vetëm për t’u pajisur me nipt pa përgjegjësi tatimore.

Në zbatim të ligjit, të VKM-së dhe Udhëzimit të sipërcituara, fermerëve u lind detyrimi për t'u përfshirë në skemën e TVSH-së (pra, të tatonen dhe të paguajnë detyrim për aktivitetin bujqësor), vetëm pasi kalojnë shumën e të ardhurave mbi 5.000.000 lekë”.

Subjekti në cilësinë e provës ka depozituar një raport vlerësimi³⁹ për të ardhurat e krijuara nga pemëtaria në vite nga një ekspert vlerësues i pasurive. Sipas aktit të ekspertimit, të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit në total, për periudhën 1996 – 2016, janë afërsisht në vlerën 1.290.000 lekë. Kjo shumë nuk përputhet me çfarë ka deklaruar subjekti, pasi ka deklaruar si të ardhura të përfituara nga bujqësia, për periudhën 1992 – 2016, shumën 7.000.000 lekë.

Në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme, subjekti ka depozituar dokumentacion⁴⁰ provues.

3.6 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se:

- Subjekti i ka deklaruar rregullisht të ardhurat nga pemëtaria për periudhën nga 2003 – 2016.
- Subjekti rezulton i regjistruar personalisht me status “fermer”, sipas certifikatës së regjistrimit të lëshuar nga DRT-ja Berat, datë 15.11.2016.
- Mospërputhje deklarimesh në lidhje me të ardhurat e gjeneruara në vite nga ky aktivitet, nga verifikimi i deklarimeve në deklaratën *Vetting*, deklaratat vjetore dhe në përgjigjet e pyetësorëve nga subjekti, të evidentuara si vijon:
 - në deklaratën *Vetting*, për periudhën 1992 – 2016, të ardhurat e deklaruara nga bujqësia janë në shumën 7.000.000 lekë;
 - në deklaratat periodike vjetore, për periudhën 2003 – 2016, të ardhurat e deklaruara nga bujqësia janë në shumën 7.152.000 lekë;
 - gjatë hetimit, në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka deklaruar se për periudhën 1992 – 2000 ka realizuar të ardhurat vjetore në shumën 200.000 lekë/vit dhe, më pas, në shumën 300.000-500.000 lekë/vit. Për periudhën 1992 – 2016 subjekti duhet të kishte deklaruar më shumë të ardhura (afro 9.5 milionë lekë).
- Mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar të ardhurat e përfituara nga shitjet e prodhimeve bujqësore apo pemëtari, palëve të treta për periudhën 2003 – 2014.
- Taksa e tokës ka rezultuar e paguar për vitet 2004 – 2006, si dhe nga viti 2011 e në vijim sipas vërtetimit të lëshuar nga Njësia Administrative P.
- Duket i paqartë angazhimi në punët e bujqësisë dhe pemëtarisë, pasi subjekti dhe bashkëshortja kanë qenë të punësuar me kohë të plotë, ndërsa 3 vajzat kanë ndjekur studimet pa ndërprerje.

³⁹Raport vlerësimi të tokave bujqësore, hartuar nga eksperte arkitekthe L. B, në përgjigjet e pyetësorit ardhur në datën 24.4.2020.

⁴⁰Si vijon: (a) vërtetim lëshuar nga Administratori i Njësies Administrative P, Bashkia Kuçovë, i cili konfirmon se nga dokumentacioni që disponojnë që nga vitit 2011 dhe në vazhdim, është paguar nga z. Nazmi Troka, taksa e tokës bujqësore në shumën 2.730 lekë, për çdo vit kalendarik për të gjithë sipërfaqen e tokës që disponon; (b) librezë pagese për “taksat dhe tarifat vendore”, nga shtetasi Nazmi Troka në adresën T, Komuna P, me kod fiskal ***, për vitet 2004 – 2006, në shumat 2.800 lekë; (c) mandatarëtimi për taksën e tokës bujqësore, datë 14.5.2007, nga Nazmi Troka, në shumën 2.800 lekë, për vitin 2007 (bashkëlidhur dhe mandatet përkatëse); (ç) vërtetim lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me të cilën konfirmohet se subjekti i rivlerësimit për periudhën që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, për periudhën 1993 – 2013, nuk ka gjykuar çështje gjyqësore civile/penale me palë ndërgjyqëse shoqëritë “G” sh.p.k., “S” sh.p.k., “O.F” sh.p.k. dhe me paltë shtetasin S.D; (d) vërtetim lëshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, me të cilën konfirmohet se subjekti Nazmi Troka, nuk ka gjykuar çështje gjyqësore me pale ndërgjyqëse shoqëritë “G” sh.p.k., “S” sh.p.k., “O. F” sh.p.k dhe me paltë shtetasin S. D.

Të ardhurat e deklaruara nga subjekti, si të krijuara nga bujqësia dhe shitjet e pretenduara prej tij, rezultuan të ishin në nivel deklarativ dhe të pambështetura në dokumentacion provues. Subjekti ka dhënë deklarime kontradiktore në lidhje shumë të ardhurave të realizuara nga shitja e produkteve bujqësore.

3.7 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë e blerjes së apartamentit me burime të ligjshme, për periudhën 2003 – 2014, duke mos konsideruar të ardhurat e deklaruara në vite nga aktiviteti bujqësor.

Referuar deklaramëve periodike vjetore, për faktin se subjekti dhe familja e tij, ka disponuar tokë dhe kanë kultivuar, ndër vite, fruta dhe perime, nisur nga këto të dhëna, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vlerësuar të përlllogarisë shpenzimet e jetesës, duke i zbritur nga shporta e ushqimeve shpenzimet për fruta-perime, ndër vite, bazuar në të dhënat statistikore të publikuara nga INSTAT⁴¹. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, për periudhën 2003 – 2014, subjekti ka rezultuar me balancë negative ose pamundësi për të krijuar kursimet (*cash* dhe depozita) për blerjen e apartamentit, si dhe për të përballuar shpenzimet, në shumën prej 4.057.508 lekësh.

Për pasurinë apartament, nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar pamjaftueshmëri financiare për blerjen e tij.

3.8 Aktiviteti privat

Sikurse u deklaruar nga subjekti, ai dhe familja e tij gjatë gjithë kohës kanë ushtruar aktivitet privat bujqësor, që nga vitit 1992 e në vijim. Në vitin 2016, subjekti si fermer është pajisur me certifikatë regjistrimi, datë 15.11.2016, NIPT L***O, në Drejtorinë e Rajonale të Tatimeve Berat. Nga aktet e administruar rezulton se subjekti ushtron aktivitetin si “fermer” dhe ka lëshuar fatura tatimore, ku paraqitet në cilësinë e shitësit, për shitje të produkteve bujqësore.

Referuar dispozitës kushtetuese, të parashikuar në nenin 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës: *“Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të*

⁴¹Për vitin 2006-2007: ushqimi (pa përfshirë pijet alkoolike) mbetet një element i rëndësishëm në buxhetin familjar duke zënë 47.6 për qind të tij. Në këtë grup, peshën më të madhe e zë shpenzimi për “mish dhe nënprodukte” që përbën rreth 22.5% të buxhetit brenda grupit. Produktet që vijnë më pas për nga vlera e shpenzuar janë “qumështi, vezët dhe nënproduktet e tij” (me një peshë prej 16.1 për qind), si dhe “bukë dhe drithëra” (15.5 për qind). Nëngrupet që vijnë më pas janë perimet që zënë 14% të grupit kryesor dhe frutat që zënë 8.8%.

Për periudhën 2008 – 2011, është zbritur përqindja e grupit “për ushqim”, me vlerë 57.9 %, sipas anketës së matjes së nivelit të jetesës.

Për periudhën 2012 – 2013, është zbritur përqindja e grupit ‘për ushqim’ me vlerë 58.4%, sipas anketës së matjes së nivelit të jetesës.

Për vitin 2014 ky grup mbetet një element i rëndësishëm në buxhetin familjar duke zënë 44,3% të tij në vitin 2014. Në këtë grup mund të veçohen tre nëngrupe që zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim: “mish dhe nënprodukte”, “bukë dhe drithëra”, “qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë” që përbëjnë secili rreth 20% të buxhetit brenda grupit respektiv. Nëngrupet që vijnë më pas janë “perimet”, që zënë 14,3% të grupit kryesor dhe “frutat” që zënë 7,6% të tij.

Për vitin 2015 dhe 2016: grupi “ushqime dhe pije jo-alkoolike” mbetet elementi më i rëndësishëm në buxhetin familjar duke zënë 48,7% të tij. Tre nëngrupet që në vitin 2015, ashtu si dhe në vitet e kaluara, zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim janë: “qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë” (18,8% të buxhetit brenda grupit), “mish dhe nënprodukte” (17,4 % të buxhetit brenda grupit) dhe “bukë dhe drithëra” (17,0% të buxhetit brenda grupit). Nëngrupet që vijnë më pas janë “perimet”, që zënë 13,3% të grupit dhe “frutat” që zënë 7,9% të tij.

Burimi: INSTAT, Anketa e Buxhetit të familjes http://www.instat.gov.al/media/2068/abf_2014_final_16_09_2015_18_34.pdf;

http://www.instat.gov.al/media/2069/abf_2015.pdf dhe http://www.instat.gov.al/media/2067/buxheti_i_familjes.pdf;

http://www.instat.gov.al/media/2063/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses_2008.pdf;

http://www.instat.gov.al/media/2065/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses_2012_rishikuar.pdf

aktivitetit të mësimdhënies, akademik shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit”.

Referuar kësaj dispozite, shprehet qartë se veprimtaria fitimprurëse e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, e bujku apo tregtarit, është e papajtueshme me funksionin e gjyqtarit.

Komisioni i ka kërkuar ILDKPKI-së opinion në lidhje me aktivitetin bujqësor/privat të subjektit dhe pajtueshmërinë e këtij aktiviteti me detyrën e gjyqtarit.

ILDKPKI-ja⁴² nuk ka evidentuar konflikt interesi nga subjekti në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit privat.

Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit⁴³ ka shpjeguar se: *“Jam regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Berat dhe jam pajisur me certifikatë regjistrimi me NIPT L***O, datë 15.11.2016 dhe mbi bazën e këtij akti kam realizuar dhe shitjet e prodhimeve bujqësore, duke plotësuar fatura shitje, sipas ligjit. Lidhur me nenin 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë shpjegoj se nëse analizojmë këtë dispozitë kushtetuese që është cituar më lartë, qenia ime gjyqtar nuk e ndalon këtë veprimtari dhe nuk është në papajtueshmëri me këtë dispozitë kushtetuese. Analizoj dispozitën kushtetuese dhe citoj ‘qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore’. Nisur nga ky formulim konstatohet qartazi se veprimtaria ime së bashku me familjen bujqësore nuk është as politike dhe as veprimtari shtetërore .*

Më tej, citoj në vazhdim dispozitën kushtetuese, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës me përjashtim të aktivitetit të mësimdhënies, akademik shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit. Nga ky togfjalësh evidentohet fakti se qenia ‘fermer’ nuk është veprimtari profesionale. Nëse unë do të ushtroja aktivitet jashtë qenies gjyqtar, por që lidhet me profesionin e juristit apo të avokatit apo të pjesëmarrjeve në borde drejtuese apo në institucione shtetërore apo në shoqëri tregtare, studio ligjore etj. me qëllim fitimi do të përbënte pengesë sipas kësaj dispozite kushtetuese. Kuptimi i ligjit është qenia si punëmarrës, pra, të ofrosh punë kundrejt pagesës nga punëdhënësi dhe kjo ka si qëllim parandalimin e konfliktit të interesit. Në rastin tim unë nuk ofroj punë, por jam vetëpunësuar në tokën që disponoj familjarisht për shkak të ligjit. Parimi i së drejtës është: ajo që nuk ndalohet me ligj lejohet. Pra, kjo dispozitë kushtetuese neni 143 nuk e ndalon veprimtarinë private të gjyqtarit jashtë profesionit si në rastin konkret ‘fermer’, duke punuar familjarisht si familje bujqësore. Në vazhdim të shpjegimeve në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, nuk ka asnjë dispozitë ndaluese për këtë veprimtari.

Neni 6, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit përcakton: ‘1. Funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me: (a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike; (b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo,

⁴²Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2021.

⁴³ Datë 18.3.2021.

që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar...’.

Në nenin 7, i ligjit nr. 96 /2016 “Për Statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kufizimet për shkak të funksionit përcakton:

1. Gjatë ushtrimit të funksionit, magjistrati nuk duhet:

a) të bëjë publike të dhëna ose informacione për çështjet që i janë caktuar;

b) të bëjë publike mendimet që ka dhënë gjatë hetimeve ose seancave gjyqësore, përveç rasteve kur mendimi është publikuar nëpërmjet një vendimi;

c) të bëjë deklarata publike që mund të krijojnë përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar në një çështje të caktuar.

2. Parashikimet e pikës 1, të këtij neni, nuk e ndalojnë magjistratin të ushtrojë përgjegjësitë si magjistrat shtypi, lidhur me marrëdhëniet me publikun në gjykata dhe në prokurori.

3. Magjistrati nuk mund të marrë pjesë në grevë.

4. Magjistratit i ndalohet:

a) të administrojë, të drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit;

b) të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit;

c) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në fuqi;

ç) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar;

d) të jetë ekspertë në gjykatat vendase ose arbitër në arbitrazhin tregtar.

Në nenin 9 /1, germa “d”, të ligjit nr. 96/2016 ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, veprimtari jashtë funksionit përcakton:

1. Magjistrati lejohet të kryejë veprimtari jashtë funksionit vetëm nëse këto veprimtari:...(d) në raste se shpërblimi për veprimtarinë jashtë funksionit përfshin çdo lloj forme pagese shpërblim financiar ose kompensim të cilat nuk tejkalojnë rregullat e zakonshme të tregut.

Pra, në këto dispozita materiale të ligjit nr. 96 /2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’ nuk përcaktohen ndalime për të ushtruar aktivitetin ‘fermer’ për të siguruar të ardhura nga familja bujqësore me rregullat e tregut e theksoj toka është fituar për shkak të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ku si anëtar i ish-kooperativës bujqësore T, për gjithë familjen bujqësore. Unë vazhdoj të jetoj në fshatin T,

Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë, së bashku me familjen dhe siguroj të ardhura nga kjo veprimtari.

Shitja e produkteve bujqësore të prodhuara prej familjes bujqësore, si ‘fermer’ ku unë bëj pjesë nuk ka asnjë pengesë ligjore dhe nuk bie ndesh me nenin 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjet e tjera të evidentuara në këtë shpjegim”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor⁴⁴, ka argumentuar se: “Prej formimit të këtij institucioni në dhjetor të vitit 2018, nuk rezulton të jetë paraqitur kërkesë nga gjyqtari Nazmi Troka lidhur me këtë veprimtari. Po ashtu, referuar të dhënave arkivore, një kërkesë e tillë nuk rezulton të jetë paraqitur prej vitit 2016, në ish-KLD.

Sa i përket kërkesës së Komisionit, lidhur me përputhshmërinë e funksionit të magjistratit me aktivitetin privat të ushtruar nga z. Nazmi Troka, në referim të parashikimeve të nenit 143 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 96/2016, vlerësojmë se:…Këshilli investohet në procedurat e mësipërme vetëm mbi bazën e një kërkesë individuale të gjyqtarit, që në këtë rast mungon. Shprehja paraprakisht e një qëndrimi mbi kërkesën tuaj, mund ta ekspozojë Këshillin para një vlerësimi paraprak të çështjes, pa pasur një të tillë sipas ligjit”.

Komisioni ka vlerësuar se ushtrimi i aktivitetit të “fermerit” dhe në cilësinë e shitësit, për shitje të produkteve bujqësore nga subjekti, si një aktivitet i vazhdueshëm privat e fitimprurës, duket se është në papajtueshmëri me detyrën e gjyqtarit.

Nga hetimi i Komisionit, për këtë pasuri u konstatua se:

- Huadhënësi nuk ka pasur burime të ligjshme nga aktiviteti i tij në shtetin grek për të përballuar shpenzimet jetike të tij dhe në të njëjtën kohë për t’i dhënë huan subjektit të rivlerësimit.
- Pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për blerjen e pasurisë në shumën 4.057.508 lekë.
- Subjekti për ushtrimin e aktivitetit privat si “fermer” është në papajtueshmëri me funksionin e tij.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

3.9 Qëndrimi i subjektit

Në prapësimet e rezultateve të hetimit të depozituara në datën 22.10.2021, subjekti sqaron se:

i. Për huan në shumën 25.000 euro, marrë shtetasit A. M, subjekti ka pretenduar se kjo hua i është marrë huadhënësit nëpërmjet transfertës bankare në BKT nga llogaria bankare në datën 27.10.2014, me përshkrim “kalim N.B.T për blerje apartamenti”.

Subjekti ka vënë në dispozicion nxjerrjet e llogarive bankare në lekë dhe në euro në BKT. Nga këto akte rezulton se shtetasi A.M ka disponuar depozitë bankare me afat në shumën 30.000 euro dhe më 27.10.2014, e ka prishur këtë depozitë duke i transferuar shumën prej 25.000 euro, z. Nazmi Troka dhe diferencën prej 5.000 euro e ka rivendosur në depozite.

⁴⁴Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2021.

Subjekti ka pretenduar se këto fakte vërtetojnë se analiza financiare e Komisionit, duke e marrë gjendjen e llogarisë bankare në BKT në shumën 7.600.000 lekë, nuk është e saktë sepse burim i huas që subjekti ka marrë është, pikërisht, kjo depozitë me afat e vendosur në vitin 2013 dhe konvertuar në euro e vendosur depozitë me afat në euro në datën 15.4.2014 dhe depozita është prishur në tetor të vitit 2014, duke i dhënë hua për blerjen e apartamentit.

Subjekti ka shpjeguar se shtetasit A dhe E.M (motra e bashkëshortes dhe bashkëshorti) i kanë vënë në dispozicion nxjerrjen e llogarisë bankare në euro, të marrë nga Banka Kombëtare e Greqisë në shtetin grek, ku pasqyrohen saktë transaksionet që janë kryer në këtë llogari bankare (depozitat dhe tërheqjet), për periudhën 2000 – 2014. Në këtë dokument konstatohet se kjo llogari është mbushur gradualisht çdo vit. Në datën 11.7.2011, këta persona kanë tërhequr shumën 35.000 euro dhe më 8.8.2011, kanë tërhequr shumën 20.000 euro, që sikurse i kanë shpjeguar i ka tërhequr për shkak të pasigurisë që u krijuan në atë periudhë në bankat greke.

Subjekti ka pretenduar se është pikërisht kjo shumë monetare e depozituar vit pas viti që vërteton se shtetasi A.M ka pasur mundësi financiare për të vendosur depozita bankare duke i tërhequr në vitin 2011 dhe i ka rivendosur në BKT, në datën 17.1.2013.

Subjekti ka shpjeguar se shtëpia e banimit që shtetasi A.M ka blerë në vitin 2004, në Berat është mbuluar me shumën që ka tërhequr në vitin 2003, në vlerën 40.000 euro.

Subjekti për të vërtetuar se huadhënësi ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 25.000 euro, për periudhën 2002 – 2014, ka depozituar aktet shtesë si vijon:

- kontratë shitje nr. ***, datë 23.1.1996, me shitës A.M, i cili ka shitur një apartament në çmimin 10.000 USD;
- kontratë dhurimi nr. ***, datë 10.01.1995, me përfitues A.M dhe dhurues Q.M në shumën 3.700.000 lekë letra me vlerë;
- në datën 2.7.2013, ka rezultuar se huadhënësi ka tërhequr nga “Credins Bank” shumën 1.000.000 lekë, si këst dëmshpërblimi për shtetasin Q.M, si ish i dënuar i regjimit komunist, në bazë të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007.

Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se z. Q.M ka pasur burime të ligjshme financiare të krijuara nga punësimi i ligjshëm në Greqi në shumën 162.000 euro, për periudhën 2002 – 2014, të cilat janë konsideruar nga Komisioni, si burime të ligjshme të huadhënësit.

Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka arritur në konkluzionin e gabuar që z. Q.M s’ka pasur burime të ligjshme për t’i dhënë subjektit hua në shumën prej 25.000 euro. Në këtë shumë të akumuluar në shtetin grek, Komisioni ka analizuar vetëm burimet në shtetin grek, duke mos u thelluar në burime të tjera të ligjshme të cilat i ka krijuar edhe në Shqipëri.

Subjekti ka shpjeguar se huadhënësi z. Q.M i ka sqaruar se shuma e parave që gjendet në BKT është krijuar edhe nga burimet e ligjshme të cilat ai i ka marrë në shtetin shqiptar sipas akteve:

1. Kontratë dhurimi me nr. ***, datë 13.1.1995, në shumën 3.700.000 lekë sipas kësaj kontrate dhe prokure të posaçme të lëshuar nga xhaxhai i tij për tërheqjen e kësaj shume.

2. Me kontratën noteriale nr. ***, datë 23.8.1996, ka shitur një shtëpi në shumën 10.000 USD. Bashkëngjitur kontrata e shitblerjes.

3. Në datën 2.7.2013, me mandatin bashkëlidhur nga [“Credins Bank”, ka tërhequr shumën 1.000.000 lekë.

Subjekti ka pretenduar se këto akte i ka depozituar para Komisionit për të provuar se huadhënësi ka marrë nga xhaxhai i tij, trashëgimlënësi, shumën 3.000.000 lekë dhe letra me vlerë në shumën 3.700.000 lekë, për arsye se z. A.M (huadhënësi) është trashëgimtar i vetëm i trashëgimlënësit Q.M.

Subjekti ka pretenduar se nëse Komisioni do të mbledhë këto shuma do të rezultonte se në vitin 2013 z. Q.M, vetëm nga shteti shqiptar ka marrë këtë shumë parash, të cilat plotësojnë kriterin e burimeve të ligjshme të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Në këto kushte, subjekti ka kërkuar nga Komisionit që këto shuma t'i bashkëlidhen shumës totale prej 162.000 euro të analizës financiare. Nëse do të përfshihet në analizë edhe shuma e të ardhurave të përfituara nga huadhënësi sipas akteve mësipërm, huadhënësi do rezultonte me burime të ligjshme për dhënien e huas.

Në lidhje me analizën financiare

ii. Për të ardhurat nga bujqësia

Subjekti ka pretenduar se Komisioni duhet t'i marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat i bujqësisë ndër vite. Familja e subjektit disponon tokë bujqësore dhe ka kultivuar rregullisht fruta dhe perime. Subjekti shpjegoi se këto të ardhura i ka deklaruar rregullisht në vite në DPV, ka paguar taksën e tokës, si dhe ka provuar me dokumentacion nga institucionet shtetërore që ka pasur aktivitet bujqësor.

Me këtë arsyetim, subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të përfshijë të ardhurat e realizuara nga bujqësia si të ardhura të ligjshme, të cilat duhet të merren në konsideratë nga Komisioni.

iii. Për shpenzimet e jetesës

Subjekti ka kërkuar sërish që Komisioni të marrë në konsideratë faktin se shpenzimet për ushqim/shporta ushqimore nuk është mbuluar me të ardhurat nga pagat. Subjekti ka shpjeguar se jetesa në fshat i ka mundësuar që të prodhojnë në tokën e tyre prodhimet bujqësore, perimet, frutat dhe me punën e tyre kanë siguruar mishin, vezët qumështin dhe nënproduktet e tij, duke ndihmuar ekonominë e tyre familjare. Për këtë arsye, subjekti ka kërkuar që shpenzimet jetike janë përballuar nga puna e tyre bujqësore në fshat.

iv. Në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të fermerit, si në papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit, subjekti shpjegon se nuk ka ushtruar një aktivitet si të papajtueshëm me detyrën e gjyqtarit. Subjekti ka pretenduar se ky qëndrim konfirmohet dhe nga institucionet si ILDKPKI-ja dhe KLGJ-ja, të cilat nuk shprehen për konflikt interesi apo ushtrim aktiviteti si në papajtueshmëri me Kushtetutën.

Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se bazuar në nenin 7 ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, regjistrimi i tij me NIPT si fermer nuk përbën papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit.

Në lidhje me aktivitetin e tij të fermerit, subjekti ka pretenduar se ka qenë i rregullt në pagimin e taksave dhe tatimeve për tokën dhe në zbatim të dispozitave ligjore dhe referuar nenit 5, të Udhëzimit⁴⁵ nr. 19, datë 3.11.2014, subjekti është pajisur me NIPT fermeri. Subjekti ka pretenduar se titullin “fermer” e ka fituar (*ipso jure*) për shkak se është kryefamiljar dhe sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, toka jepej në emër të kryefamiljarit, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

Subjekti ka shpjeguar se është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Berat. Mbi bazën e këtij regjistrimi familja bujqësore ka realizuar dhe shitjen e prodhimeve bujqësore, duke plotësuar fatura shitje, për të qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Regjistrimi i subjektit si fermer është bërë prej tij për të formalizuar ekonominë bujqësore.

3.10 Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti në prapësime, vlerëson se:

i. Lidhur me huan e marrë nga shtetasi A.M, referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin që personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave.

Në lidhje me këtë hua, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka provuar marrëdhënien e huamarrjes, sipas kontratës së huas me nr. ***, datë 27.10.2014, rezulton që të jetë dhënë nëpërmjet transaksionit bankar.

Në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësit A.M, pas kalimit të barrës së provës, Komisioni analizoi provat e reja të sjella nga subjekti për burimet e ligjshme të huadhënësit, duke përfshirë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga ky shtetas, referuar akteve vijuese:

- kontratë shitje me nr. ***, datë 23.1.1996, me shitës A.M, i cili ka shitur një apartament në çmimin 10.000 USD;
- kontratë dhurimi me nr. ***, datë 10.1.1995, me përfitues A.M, i cili ka përfituar nga dhuruesi Q.M shumën 3.700.000 lekë letra me vlerë.
- në datën 2.7.2013, ka rezultuar se huadhënësi ka tërhequr nga “Credins Bank” shumën 1.000.000 lekë, si këst dëmshpërblimi për z. Q.M, si ish i dënuar i regjimit komunist në bazë të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007.

Siç vërehet në parashtrimet e tij, subjekti kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke iu referuar gjendjes së llogarisë bankare në BKT, e cila ka shërbyer si burim i huas, që subjekti ka marrë depozitë me afat që në vitin 2013, duke deklaruar se shtetasi A

⁴⁵ Për zbatimin e regjimit të ççantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar.

dhe E.M, motra e bashkëshortes i kanë vënë në dispozicion nxjerrjen e llogarisë bankare në euro të marrë nga Banka Kombëtare e Greqisë në shtetin grek, ku pasqyrohen saktë transaksionet që janë kryer në këtë llogari bankare (depozitat dhe tërheqjet) për periudhën 2000 – 2014. Në këtë dokument konstatohet se kjo llogari është mbushur gradualisht çdo vit. Në datën 11.7.2011, këta persona kanë tërhequr shumën 35.000 euro dhe më 8.8.2011 kanë tërhequr shumën 20.000 euro, që sikurse kanë shpjeguar i kanë tërhequr për shkak të pasigurisë që u krijua në atë periudhë në bankat greke.

Subjekti ka pretenduar se është pikërisht kjo shumë monetare e depozituar vit pas viti që vërteton se shtetasi A.M ka pasur mundësi financiare për të vendosur depozita bankare, duke i tërhequr në vitin 2011 dhe i ka rivendosur më 17.1.2013, në BKT.

Por, sipas pikës 4 të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti duhet të vërtetonte bindshëm burimin e të ardhurave të huadhënësit për krijimin e këtyre depozitave dhe, për rrjedhojë, shumës së dhënë hua. Pas analizimit në tërësi të dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe atij të depozituar në prapësime, shumica e trupit gjykues arriti në përfundimin se huadhënësi nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huas në shumën 25.000 euro, referuar tabelës vijuese.

Përshkrimi	Periudha 2002 - 2014
Të ardhura total	25 505 112
Shpenzime jetese për tre persona, për 12 vjet	25 188 344
Blerje apartamenti në Berat më 20.9.2004	3 000 000
Blerje garazhi në Berat më 10.6.2005	500 000
Dhënie hua subjektit	3 502 750
Mundësia financiare	- 6 685 981

Ky qëndrim mbi pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, bazohet pikërisht në faktin që subjekti ka dështuar të provojë me dokumentacion të vlefshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumave të dhëna hua. Ndonëse është provuar prezenca e shumave të caktuara në llogaritë bankare të huadhënësit, ky fakt në vetvete nuk mjafton për të mbërritur në konkluzionin se disponibiliteti financiar përkon me ligjshmërinë e burimit të ligjshëm, sipas parashikimeve të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të lartpërmendura.

ii. Për të ardhurat e realizuara nga bujqësia, subjekti pas kalimit të barrës së provës, nuk solli prova dhe fakte të reja që të provonte të kundërtën e rezultateve të hetimit. Subjekti nuk arriti të provojë të ardhurat e përfituara nga shitjet e prodhimeve bujqësore apo pemëtari të palët e treta, për periudhën 2003 – 2014.

Subjekti provoi me dokumentacion se kish paguar taksën e tokës vetëm për vitet 2004 – 2006 si dhe nga 2011 e në vijim, referuar vërtetimit të lëshuar nga Njësia Administrative Perondi.

Të ardhurat e krijuara nga bujqësia, ngelën në nivel deklarativ, të pa mbështetur në dokumentacion provues, për shitjet e produkteve dhe marrëdhënie me palët blerëse.

Për pasojë, subjekti nuk provoi të ardhurat e krijuara nga aktiviteti bujqësor, si rrjedhojë shumat e pretenduara prej tij, nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

iii. Komisioni mori në konsideratë pretendimet e subjektit se bashkë me familjen e tij, ka banuar gjithë jetën në fshat, si dhe duke disponuar sipërfaqe të madhe toke në një formë, këtë tokë e ka vënë në funksion të familjes së tij. Subjekti nuk arriti t'i provonte Komisionit se kishte krijuar të ardhura nga bujqësia, por me provat e reja që solli, bindi Komisionin se nga ky aktivitet, kishte mundur të ndihmonte ekonominë e tij familjare. Megjithatë, Komisioni konstatoi se subjekti ndër vite asnjëherë nuk ka deklaruar shpenzime për mirëmbajtjen e ekonomisë në fshat, që do të thotë, blerjen e lopës, pulave, blerjen e farave apo kosto të tjera shtesë për mirëmbajtjen dhe rritjen e tyre.

Analiza financiare e kryer për periudhën 2003 – 2014 (duke ulur shpenzimet e jetesës sipas shportës)

VITET	PASURI	DIFERENCE LIKUIDITETII	DETYRIME	PASURINETO	TEARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI FINANCIAR
2003	1 063 051	463 051	-	1 063 051	874 909	246 186	- 434 327
2004	574 947	574 947	-	574 947	1 041 081	361 656	104 478
2005	592 593	592 593	-	592 593	1 119 674	443 278	83 803
2006	704 479	704 479	-	704 479	1 111 289	315 491	91 320
2007	477 933	477 933	-	477 933	1 157 665	393 740	285 991
2008	950 301	950 301	-	950 301	1 254 671	287 585	16 785
2009	1 134 329	1 134 329	-	1 134 329	1 564 672	306 536	123 807
2010	425 062	425 062	-	425 062	1 617 173	719 348	472 763
2011	82 656	82 656	- 200 000	282 656	1 688 594	711 386	694 552
2012	728 318	728 318	-	728 318	1 949 152	1 146 498	74 337
2013	996 351	996 351	-	996 351	1 530 900	905 896	- 371 347
2014	2 301 613	- 7 085 757	-	2 301 613	1 920 961	706 153	- 1 086 804
Rezultati financiar total							- 1 892 478

Pas kryerjes së analizës financiare, subjekti rezultoi në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 1.892.478 lekë.

iv. Komisioni konstatoi se veprimtaria e fermerit e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit është në papajtueshmëri me detyrën e gjyqtarit, referuar nenit 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: "*Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit të mësimdhënies, akademik shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit*".

Veprimtaria e fermerit, e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, është një veprimtari tregtare e cila ushtrohet kundrejt pagesës në mënyrë të vazhdueshme dhe subjekti lëshon fatura tatimore në emrin e tij si fermer. Një person nuk mund të jetë në të njëjtën kohë dhe gjyqtar dhe fermer. Ky veprim është i papajtueshëm me figurën e magjistratit, të cilit ligji i ka lejuar të ushtrojë vetëm aktivitetin e mësimdhënies dhe asnjë aktivitet tjetër fitimprurës.

Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar të jetë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në Tiranë.

4. Automjet tip “Mercedes-Benz, * D”, i vitit 1989 me targa AA *** AN**

Vlera e deklaruar: 500.000 lekë.

Burimi i krijimit: Blerë nga kursime e pagës së subjektit dhe bashkëshortes dhe nga të ardhurat e siguruar nga toka bujqësore sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 22.4.2003.

Deklarimi në DPV⁴⁶: subjekti ka deklaruar se është blerë me kursime, zotëron ½ e automjetit dhe e ka blerë në vlerën 600.000 lekë.

Statusi aktual: ende në pronësi të subjektit.

Nga verifikimi i akteve rezulton se subjekti me kontratën e shitblerje nr. ***, datë 22.4.2003, i ka blerë shitësit Z. B dhe automjetin “Mercedes-Benz” tip *** D, në çmimin 500.000 lekë.

4.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRr-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, konfirmon automjetin me targa AA *** AN, në pronësi të shtetasit Nazmi Trokës.

Gjithashtu, konfirmohet se personat e tjerë të lidhur me subjektin nuk kanë në pronësi automjete.

AMF-ja, informon se ky është i vetmi automjet që subjekti ka në përdorim, për të cilin ka paguar siguracionet e detyrueshme periodike.

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se:

➤ **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRr-së.**

Nga verifikimi rezultoi mospërputhje në DPV-në e subjektit, në lidhje me çmimin e automjetit, pasi e ka deklaruar si të blerë në shumën 600.000 lekë, ndërsa kontrata e shitblerjes ka të përcaktuar si çmim të blerjes shumën prej 500.000 lekësh. Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti iu kërkua të jepte shpjegime.

4.2 Analiza financiare

Në analizën financiare për blerjen e automjetit, u morrë në konsideratë shuma e deklaruar në DPV-në e vitit 2003.

- Të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes u përlllogaritën për katër muaj sipas vërtetimeve lëshuar nga institucionet përkatëse.
- Shpenzimet, gjithashtu, u përlllogaritën në shumën 138.597 lekë.

⁴⁶ E vitit 2003.

- Shpenzimet për pagesat e kredisë në Fondin B u bazuan në shkresën lëshuar nga ky institucion, ku vërtetohen pagesat e kryera në shumën 115.470 lekë.
- Gjendja e kursimeve *cash* u përlllogarit me përafërsi për 4 muaj, bazuar në deklarinimin e subjektit në DPV.

Për analizimin e mundësive financiare për blerjen e automjetit u analizuan të ardhurat, për periudhën 1.1.2003 – 22.4.2003, pasi rezulton mungesë informacioni në lidhje me kursimet përpara vitit 2003.

Nga hetimi i kryer për blerjen e këtij automjeti ka rezultuar:

- Mungesë burimesh të ligjshme në shumën 423.157 lekë, nga analiza financiare e kryer.
- Mospërputhje në lidhje me çmimin e blerjes së automjetit, pasi në DPV subjekti e ka deklaruar si të blerë në shumën 600.000 lekë, ndërsa kontrata e shitblerjes ka përcaktuar si çmim të blerjes shumën 500.000 lekë.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, Aneksit të Kushtetutës.

4.3 Qëndrimi i subjektit

Subjekti ka pretenduar se deklarimi i shumës prej 600.000 lekësh, si çmimi i blerjes së automjetit është një lapsus prej tij në deklarim, pasi automjeti është blerë në shumën 500.000 lekë.

Subjekti ka argumentuar se fakti që nuk kanë pasur mundësi për t'i deklaruar këto kursime, pasi fillimisht është deklaruar në vitin 2003, nuk do të thotë që ai dhe familja e tij nuk kanë disponuar të ardhura dhe se gjendja në fillim të vitit 2003 ka qenë zero. Subjekti ka shpjeguar se ka deklaruar për herë të parë në fund të vitit 2003 dhe nuk ka pasur asnjë mundësi për t'i deklaruar këto kursime që janë përdorur për blerjen e automjetit në prill të vitit 2003.

Në lidhje me mundësinë e tij financiare për të blerë automjetin në prill të vitit 2003, subjekti ka shpjeguar se janë përdorur kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes në vitet 2001, 2002 dhe deri në prill të vitit 2003. Për këtë arsye, duhet të pranohen shpjegimet e tij se ka disponuar të ardhura nga pagat e tij dhe të bashkëshortes

4.4 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni mori në konsideratë shpjegimet dhe i konsideron të drejta pretendimet e subjektit, duke i reflektuar në analizën financiare vijuese:

Përshkrimi	Periudha 1.1.2003 – 22.4.2003
PASURI	675 000
Autoveturë “Mercedes-Benz”, me targa BR***A	600 000
LIKUIDITETE	75 000
Gjendje <i>cash</i>	75 000
DETYRIME	115 470
Kredia Fondi B	115 470

PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	559 530
TË ARDHURA	1 491 901
Të ardhura nga paga të subjektit	1 196 733
Të ardhura nga paga të bashkëshortes	295 167
SHPENZIME	469 320
Shpenzime jetese	469 320
REZULTATI FINANCIAR	463 051

➤ Përfundimisht, ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit.

5. Gjendje në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank”, deri në datën 23.1.2017, në vlerën 202.404 lekë

“Raiffeisen Bank”⁴⁷ konfirmon llogarinë e pagës së subjektit me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 202.404 lekë.

➤ Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

6. Në lidhje me kursimet *cash* në shumën 1.000.000 lekë të deklaruar në deklaratën *Vetting*, të krijuara nga kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes, si dhe me të ardhurat e realizuara nga pemëtaria.

6.1 Nga verifikimi i deklarimeve duket se ka një mospërputhje në deklaratimet e subjektit, pasi në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar shumën 1.500.000 lekë. Sa më sipër, në analizën financiare të kryer u konsiderua shuma e deklaruar në DPV-në përkatëse.

6.2 Analiza financiare sipas tabelës në vijim:

Përshkrimi	Viti 2016
PASURI	1 179 578
DIFERENCË LIKUIDITETI	1 179 578
LIKUIDITETE	1 766 345
Gjendje <i>cash</i>	1 500 000
Likuiditete ne banke	266 345
DETYRIME	-
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1 179 578
TË ARDHURA	1 957 214
Të ardhura nga paga të subjektit	1 390 039
Të ardhura nga paga të bashkëshortes	567 175
SHPENZIME	1 545 867

⁴⁷Shkresë nr. ***a prot., datë 4.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

Shpenzime jetese	926 838
Shpenzime udhëtimi	180 329
Shpenzime udhëtimi Kuçove – Vlorë	96 000
Shpenzime shkollimi	342 700
REZULTATI FINANCIAR	-768 231

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për krijimin gjendjes *cash*, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën 768.231 lekë.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikë 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

6.3 Qëndrimi i subjektit

Subjekti ka pretenduar që të ardhurat e deklaruara janë krijuar nga aktiviteti bujqësor dhe pemëtaria deklaruar në mënyrë të rregullt prej tij dhe për të cilën ka paguar detyrimet përkatëse sipas kërkesave ligjore.

Subjekti i ka kërkuar Komisionit që t'i merren në konsideratë të ardhurat nga bujqësia dhe pemëtaria (sipas aktit të ekspertizës të paraqitur pas kalimit të barrës së provës në Komision).

Gjithashtu, subjekti ka kërkuar që shpenzimet jetike në fshat të llogariten si të përballuara kryesisht me të ardhurat nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Për këtë arsye, subjekti ka kërkuar nga Komisioni që shpenzimet e shportës së ushqimeve të mos i zbriten nga të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, por të përlllogariten si të përballuara nga prodhimet e realizuara nga toka bujqësore në pronësi.

6.4 Vlerësimi i Komisionit

Sikurse u arsyetua më lart, subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion provues se kishte krijuar të ardhura nga aktiviteti bujqësor. Me provat që depozitoi, pas kalimit të barrës së provës, subjekti arriti të bindë Komisionin se nga ky aktivitet bujqësor kishte mundur të ndihmonte ekonominë e tij familjare.

Në analizim dhe vlerësim të provave të depozituar pas kalimit të barrës së provës, si dhe të provave të administruara gjatë hetimit dhe në vlerësim të çështjes në tërësi, Komisioni në përfundimin krijoi bindjen se produktet bujqësore si, fruta e perime, bulmet, vezë, qumësht etj., kryesisht pjesë përbërëse e shportës së ushqimeve janë prodhuar prej familjes së tij bujqësore dhe kanë shërbyer për të mbuluar nevojat e tij familjare.

Për pasojë, analiza financiare, pas prapësimeve të subjektit ka rezultuar me balancë negative në shumën 384.103 lekë.

Duke marrë në konsideratë pjesërisht pretendimet e subjektit në prapësime ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 1.000.000 lekë të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

7. Automjet tip “Fiat Punto”, në përdorim, me targa AA *** JA

Ky automjet është në pronësi të shtetasës E. D. M (motra e bashkëshortes). Nuk disponohet akt përdorimi.

Subjekti ka paraqitur lejen e qarkullimit nr. BRD***, për automjet tip “Fiat Punto”, me targa AA *** JA, në emër të shtetasës E.M. Nga faqja zyrtare e AMF-së ka rezultuar se shtetasja E. M është pronare dhe në të njëjtën kohë blen rregullisht policat e sigurimit të detyrueshëm për këtë automjet. Subjekti deklaron përdorim të këtij automjeti nga bashkëshortja e tij, duke shpjeguar se pronarja e këtij automjeti është motra e bashkëshortes. Në përgjigjet e pyetësorit standard⁴⁸, subjekti ka deklaruar se: *“Në periudhën nga viti 2014 dhe në vazhdim bashkëshortja, përdor automjetin në pronësi të motrës saj E.M, automjet tip ‘Fiat Punto’, prodhim i vitit 2003, me targa AA *** AJ”*.

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në përdorim.

8. Deklarimi i të ardhurave

Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar të ardhura⁴⁹ të familjes, si vijon:

- Të ardhura: për periudhën kohore 23.10.1993 – 1.1.1994, ndihmës gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë; për periudhën 1.7.1994 – 30.6.1998, gjyqtar në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Kuçovë; për periudhën 30.6.1998 – 23.10.2013, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe për periudhën 23.10.2013 – 31.12.2016, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, në vlerën 17.117.998 lekë.
- Të ardhura nga paga e bashkëshortes si mësuese: për periudhën janar 1995 – gusht 2000, shkolla “S.Gj”, Ura Vajguore; për periudhën 1.9.2000 – 31.12.2016, shkolla “** N”, Kuçovë, në vlerën 6.544.038 lekë.
- Të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore (fruta dhe perime) të siguruara nga toka bujqësore e ndodhur në fshatin T, Njësia Administrative P, Bashkia Kuçovë, me sipërfaqe 8.000 m², në bashkëpronësi të familjes bujqësore, kryesisht pemëtari, për periudhën 1992 – 2016, në shumën 7.000.000 lekë. Me NIPT L***O, lëshuar më datë 15.11.2016, në emër të shtetasit Nazmi Troka, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, (trajtuar sa më sipër në pikën 3.4/b të këtij vendimi).

9. Detyrime financiare

9.1 Detyrim i mbetur ndaj huadhënësit A. M në vlerën 13.000 euro, detyrim sipas kontratës së huas për blerje apartamenti në Tiranë, datë 27.10.2014. Për transaksionin e kryer në datën

⁴⁸Ardhur me postën elektronike të datës 30.4.2019.

⁴⁹Subjekti ka paraqitur: vërtetim të ardhurash, nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, për subjektin Nazmi Troka, për periudhën 23.10.1993 – 31.12.1998, në vlerën 870.936 lekë; vërtetim të ardhurash, nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat për subjektin Nazmi Troka, për periudhën 1.7.1998 – 23.10.2013, në vlerën 11.862.301 lekë; vërtetim të ardhurash Gjykata e Apelit Vlorë, nr. ** prot., datë 27.1.2017, për subjektin Nazmi Troka, për periudhën 24.10.2013 – janar 2017, në vlerën 4.384.761 lekë; vërtetim të ardhurash Bashkia Kuçovë, Qendra Ekonomike e Arsimit, datë 20.10.2016, për znj. P.T, për periudhën 2000 - 2007, në vlerën 1.582.439 lekë; vërtetim të ardhurash Bashkia Kuçovë, Qendra Ekonomike e Arsimit, nr. *** prot., datë 20.10.2016, për periudhën 2008–2016, në vlerën 4.574.515 lekë; vërtetim të ardhurash Instituti i Sigurimeve Shoqërore Berat, nr. *** prot., datë 25.1.2017, për znj. P.T, për periudhën 1996 – 2000, në vlerën 434.597 lekë; vërtetim, nr. *** prot., datë 21.10.2016, Bashkia Kuçovë, sipas të cilit vërtetohet se subjekti Nazmi Troka ka tokë bujqësore me sip.8000 m² në fshatin T, Bashkia Kuçovë, e cila shfrytëzohet që nga viti 1991 dhe kultivohen pemë frutore nga e cila siguron të ardhura; vërtetimet nr. *** prot., datë 21.10.2016 dhe nr. *** prot., datë 21.10.2016, të Bashkisë Kuçovë, Zyra e Tatim Taksave, me të cilin vërtetohet se subjekti Nazmi Troka ka shlyer detyrimet tatimore ndaj Njesisë Administrative P, Bashkia Kuçovë; certifikatë Regjistrimi, datë 15.11.2016, nga DRT-ja Berat, me të cilën subjekti Nazmi Troka regjistrohet si fermer.

27.10.2014, nga BKT, marrë hua nga z. A.M, nëpërmjet” Raiffeisen Bank” te Nazmi Troka. Kohëzgjatja e shlyerjes së kontratës deri në datën 31.12.2019.

Nga verifikimi i DPV-ve nga viti 2014 dhe në vijim, subjekti ka deklaruar saktë detyrimin ndaj shtetasit A.M dhe shlyerjet përkatëse.

9.3 Komisioni kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e subjektit për të paguar me burime të ligjshme për këstin prej 7.000 euro, më 31.12.2015, si detyrim i mbetur huadhënësit.

Nga analiza financiare e kryer ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e këstit të huas në vitin 2015, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën 466.286 lekë.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

9.4 Qëndrimi i subjektit

Subjekti ka pretenduar që nëse nga Komisioni do të merren në konsideratë të ardhurat e realizuara nga pemëtaria dhe blegtoria, sipas aktekspertizës të depozituar prej tij, si dhe të hiqen nga analiza financiare shpenzimet e shportës ushqimore, pasi këto shpenzime janë përballuar nga prodhimet bujqësore e blegtorale të realizuara nga puna e tij dhe e familjes, atëherë do të rezultojë se ka pasur burime të ligjshme për të bërë pagesën e këstit të huas duke rezultuar me balancë pozitiv në shumën 573.655 lekë.

9.5 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, sikurse ka arsyetuar edhe më lart, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për t'i ulur shpenzimet e jetesës, duke zbritur shportën ushqimore, nga analiza financiare e kryer, subjekti përfundimisht rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 27.086 lekë, për vitin 2015.

Analiza e përgjithshme financiare

VITET	PASURI	DIFERENCA LIKUIDITETI	DETYRIME	PASURINETO	TE ARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI FINANCIAR
2003	1 063 051	463 051	-	1 063 051	874 909	246 186	- 434 327
2004	574 947	574 947	-	574 947	1 041 081	361 656	104 478
2005	592 593	592 593	-	592 593	1 119 674	443 278	83 803
2006	704 479	704 479	-	704 479	1 111 289	315 491	91 320
2007	477 933	477 933	-	477 933	1 157 665	393 740	285 991
2008	950 301	950 301	-	950 301	1 254 671	287 585	16 785
2009	1 134 329	1 134 329	-	1 134 329	1 564 672	306 536	123 807
2010	425 062	425 062	-	425 062	1 617 173	719 348	472 763
2011	82 656	82 656	- 200 000	282 656	1 688 594	711 386	694 552
2012	728 318	728 318	-	728 318	1 949 152	1 146 498	74 337
2013	996 351	996 351	-	996 351	1 530 900	905 896	- 371 347
2014	2 301 613	- 7 085 757	-	2 301 613	1 920 961	706 153	- 1 086 804
2015	205 556	205 556	- 963 550	1 169 106	1 950 381	808 362	- 27 086
2016	1 179 578	1 179 578	-	1 179 578	1 957 214	1 161 739	- 384 103
Rezultati financiar per periudhën 2003-2016							- 2 303 668
Rezultati financiar për pasurinë: shtëpi dy kate në fshatin Tapi							- 1 534 073
Rezultati financiar total							- 3 837 740

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni për vlerësimin e kriterit të pasurisë, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancat dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Nazmi Troka:

- i. Nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurive, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve, në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Ka mungesë dokumentacioni provues për të ardhurat e deklaruara nga pemëtaria.
- iv. Ka deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- v. Subjekti ka ushtruar aktivitetin privat të fermerit në papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Nazmi Troka, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.11.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha